

**BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM**

**RREGULLAT E SJELJES GJATË FITIMIT DHE  
SIGURIMIT TË JETESËS**

Imam Gazali

Prishtinë, 2017

**Titulli i origjinalit:**

*Kitâbu Adâbi'l – Kesb ve'l Meash*

*Ihjau Ulumid-din*

Ringjallja e diturive fetare

Imam Gazali

**Përgatiti dhe përktheu**

Ishak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

**Lektor:**

Shenaj Zeneli

## PËRMBAJTJA

<b>VLERA E FITIMIT DHE NXITJA PËR FITIM</b> .....	9
<b>KORREKTËSIA E KËMBIMT NË TREGTI</b> .....	25
MARRËVESHJA PËR KAMATËN .....	46
PAGESA E PARAKOHSHME DHE DORËZIMI I MËVONSHËM I MALLIT.....	50
QIRAJA .....	53
KAPITALI DHE PUNA .....	59
ORTAKËRIA.....	63
<b>LARGIMI NGA PADREJTËSIA DHE PËRSHTATJA DREJTËSISË NË TREGTI</b> .....	67
DËMI I PËRGJITHSHËM .....	67
DËMTIMI I MYSHTERISË.....	79
<b>MIRËBËRJA NË TREGTI</b> .....	103
<b>KUJDESI I TREGTARIT PËR AHIRETIN DHE IMANIN E VET</b> .....	121



## ***Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!***

### PARATHËNIE

*Hamd (Falënderimi) i takon vetëm Allahut Teala. E falënderoj Allahun, si një besimtar me bindjen se do të zhduket çdo gjë, pos Tij. Edhe unë shprehi respekt, sikur që shprehin ata që thonë haptas se, po të mblidhen bashkë gjithë çka janë në qiej e në Tokë për të krijuar vetëm një mushkonjë, bile një thërmijë, nuk do të mund ta bëjnë, dhe se gjithçka pos Tij, është një hiç.*

*E falënderojmë Allahun, që robëve të Tij ua bëri qiellin strehë të përforcuar e Tokën shtrojë. E mbështjelli natën rreth ditës dhe robi e ka natën si mbulesë, e ditën e bëri të përshtatshme për punë, që njerëzit të shpërndahen nëpër botë në kërkim të bereqeteve të Tij e të furnizohen me atë që ua plotëson nevojat e kësaj jete.*

*Salavat e selam i dërgojmë Resulallahut, nga burimi i të cilit (Kevther) do të pinë muminët, për t'a shuar etjen përgjithmonë. Salavat i dërgojmë edhe familjes së tij (ehli-bejtit), si edhe as'habëve, që ndihmuan Islamit me të gjitha mundësitë e tyre, dhe nuk u luhatën nga rruga e drejtë.*

Pastaj dije se: Allahu Tela është krijuesi i sebepeve, ahiretin e ka krijuar si vend të shpërblimit dhe dënimit, ndërsa këtë botë (dynjanë), vend të përpjekjes, provës dhe shqetësimit, edhe përballë kushteve materiale të domosdoshme për të jetuar, siç janë ushqimi, veshja, banimi e të tjera.

Prandaj, në dynja nuk punohet vetëm për ahiret por duhet të punohet edhe për dynja. Ndoshta, sigurimi i jetesës në këtë botë është rrugë për të fituar ahiretin, dhe ndihmesë ahiretit. Sepse dynjaja është arë (ku mbjellet fara) e ahiretit dhe mjet udhëtimi për në ahiret.

E në çështjen e fitimit, njerëzit ndahen në tri kategori:

a) Njerëzit që janë të zënë me sigurimin e jetesës dhe kanë harruar ahiretin; këta janë në shkatërrim.

b) Ata të cilët telashi i ahiretit i ka bërë të harrojnë dynjallëkun. Këta kanë arritur në fitore.

c) Ata që janë zënë me dynjallëk për të fituar ahiretin. Këta janë më së afërti gradës së maturisë,

dhe quhen ‘*muktesit*’ (ekonomik). Kjo është shkalla salah<sup>1</sup>, dhe kjo është shkalla e mesme.

Ai që gjatë sigurimit të kushteve të jetesës nuk i përmbahet rrugës së drejtë dhe nuk respekton maturinë, ai nuk mund të quhet *ekonomik*. Nëse jeta në këtë botë nuk është në përputhje me rregullat e sjelljes (edeb) të shariatit, ajo nuk mund të bëhet mjet udhëtimi për në ahiret.

Pra, ne këtu do të mundohemi të shpjegojmë tregtinë, zejtarinë dhe rrugët tjera të shumëllojshme të fitimit të ligjshëm, dhe këto do t’i shpjegojmë përmes pesë kapitujve:

1. *Vlera e fitimit dhe nxitja për fitim;*
2. *Korrektësia e këmbimit në tregti;*
3. *Largimi nga padrejtësia dhe përshtatja drejtësisë në tregti;*
4. *Mirëbërja në tregti; dhe në fund:*
5. *Kujdesi i tregtarit për ahiretin dhe për imanin e vet.*

---

<sup>1</sup> **Salah:** gjendja më e mirë e një sendi; rehati; qetësi; paqe; mirësi; lidhje me fe





Kapitulli i parë  
**VLERA E FITIMIT DHE NXITJA PËR FITIM**

**Ajetet në këtë çështje**

**“...ditën e kemi caktuar për jetesë (ekonomizim).”** 78-Nebe: 11,

**“Ne ju vendosëm në tokë dhe ju mundësuam jetesën (mjetet për të jetuar), e pak prej jush po falënderoni.”** 7-Enam: 10,

**“Nuk është gjynah të kërkonti nga Zoti juaj ndonjë të mirë.”** 2-Bekare: 198,

**“...disa do të udhëtojnë nëpër botë, duke kërkuar mirësitë e Tij (për jetesë).”** 73-Muzemil: 20,

**“...shpërndahuni nëpër tokë, kërkonti nga mirësitë e Allahut.”** 62-Xhuma: 10.

**Hadithet në këtë çështje**

**Ka gjynahe të tilla, që mund t'i fshijë vetëm brenga për sigurimin e jetës për familjen.<sup>2</sup>**

---

<sup>2</sup> Hadithin e kemi përmendur në librin ‘*Rregullat e jetës martesore*’.

**Tregtari i sinqertë, në Ditën e Kijametit do të ngjallet me siddikët dhe shehidët.<sup>3</sup>**

**Kush fiton hallall, duke u ruajtur nga lypësaria për të siguruar kushtet e jetesës së familjes, për të ndihmuar komshijtë e varfër, në takim me Allahun, fytyra e tij do t'i shndërris si hënë e plotë.<sup>4</sup>**

As'habët panë një djalë të ri e të fuqishëm, që herët në mëngjes po nisej për punë, dhe thanë:

*- I mjeri, sikur rininë e fuqinë t'i përdorte në rrugë të Allahut!”,*

e në këtë, Resulallahu s.a.v.s., ju tha:

**Mos folni kështu; nëse punon për vete, që të ruhet nga lypësaria e të jetë i pavarur prej njerëzve, është në rrugë të Allahut.**

**Nëse punon për prindërit pleq e të dobët, ose për fëmijët ende të pafuqi, që edhe ata t'i bëjë të pavarur dhe t'ju plotësojë nevojat, prapë është në rrugën e Allahut.**

**E nëse punon për t'u lavdëruar e për të grumbulluar pasuri, atëherë është në rrugë të shejtanit.<sup>5</sup>**

---

<sup>3</sup> Tirmidhiu dhe Hakimi nga Ebu Seid. Ibn Maxhe dhe Ibn Hakimi shënojnë hadith të ngjashëm edhe nga Omeri r.a.

<sup>4</sup> Ebu Shejh në veprën '*Kitabus-sevab*', Ebu Nuajm në veprën '*Hilje*', Bejhekiu në '*Shuabu'l-iman*', nga Ebu Hurejre r.a..

<sup>5</sup> Taberani, nga Ka'b b. Uxhra.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**Allahu Teala e do atë që merret me ndonjë punë për t'u bërë i pavarur nga njerëzit, e nuk e do atë që mëson dituri, për t'a bërë diturinë fitim.<sup>6</sup>**

E në një tjetër hadith:

**Allahu e do muminin e angazhuar në ndonjë zanat.<sup>7</sup>**

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**Ushqimin më hallall robi e ka kur vet e fiton, e secila shitblerje e lejuar, është e mirë<sup>8</sup>,**

e në hadith të ngjashëm:

**Më e hallallit që robi mund të hajë është ajo që zanatliu e fiton me duart e veta, nëse është i ndershëm.<sup>9</sup>**

Resulallahu s.a.v.s., na fton:

**Merruni me tregti, në të janë nëntë nga dhjetë pjesët e riskut.<sup>10</sup>**

---

<sup>6</sup> Hadithi nuk është gjetur në këtë formë. Kurse në veprën 'Musnedu'l Firdevs', Ebu Mensur el-Delejmi përcjellë nga Alia r.a. hadithin, në këtë kuptim:

*Allahut i pëlqen të shohë robin e vet të lodhet duke kërkuar hallallin.*

<sup>7</sup> Taberani dhe Ibn Adijj, nga Ibn Omeri r.a..

<sup>8</sup> Ahmedi nga Rafi b. Hudexh. Bezar dhe Hakimi, që pohon se është sahih, nga Seid b. Umejri.

<sup>9</sup> Shënon Ahmedi nga Ebu Hurejre r.a., me sened të mirë.

Tregohet se Isa a.s., e takoi një njeri, dhe e pyeti:

- *Çfarë bën ti?*, ai iu përgjigj:

- *Bëj ibadet*. Isa a.s., e pyeti prapë:

- *Kush t'i siguron kushtet e jetesës?*, e ai u përgjigj:

- *Vëllai*. Isa a.s. i tha:

- *Vëllai yt është besimtar më i mirë se ti*.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**Unë ju kam urdhëruar ato për të cilat e di se ju afrojnë xhenetit e ju largojnë nga xhehenemi, dhe ju kam ndaluar ato për të cilat e di se ju largojnë nga xheneti e ju afrojnë xhehenemit.**

**Ruhu'l-Emin (Xhebraili a.s.) më fryu në zemër (njohurinë) që askush nuk do të vdesë deri sa të mos e harxhojë riskun e vet, sado që ajo ndonjëherë vjen me vonesë. Prandaj frikësohuni Allahut, dhe kërkoni riskun hallall...<sup>11</sup>,**

na ka urdhëruar që riskun ta kërkojmë në hallall, e nuk na ka thënë: ***“Largohuni nga tregtia!”***

---

<sup>10</sup> Ibrahim Harbi në *'Garibu'l-Hadith'* nga Nuajm b. Abdullahman.

<sup>11</sup> Ibn Ebu Dun'ja në *'El-Kana'a'*, dhe Hakimi nga Ibn Mesud r.a. Gjithashtu Bejhakui në *'Shu'abu'l-Iman'*.

E në fund të këtij hadithi, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**...arritja e ngadaltë e riskut nuk duhet t'ju shtyej në haram, e t'a kërkoni atë me gjynahe ndaj Allahut, sepse ajo që është tek Allahu nuk mund të merret me kryengritje ndaj Tij.**

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

**Pazaret janë sofrat e Allahut Teala, e kush t'ju afrohet, merr diçka prej aty.<sup>12</sup>**

Resulallahu s.a.s.v., pohon:

**Më mirë e ka robi të merr konopin e të ngarkojë dru në shpinë, se sa të shkojë e te lypë te dikush të cilit Allahu Teala i ka dhënë nga bereqetet e Tij, pa marrë parasysh a i jep ky diçka a jo<sup>13</sup>,**

dhe thotë:

**Atij që ia hapë vetes një derë të lypësarisë, Allahu Teala ia hapë dhjetë dyer të fukarallëkut.<sup>14</sup>**

---

<sup>12</sup> E kemi përmendur në *'et-Tujurijattu'*, të përcjellë nga Hasan Basri, por nuk e kemi gjetur si hadith.

<sup>13</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejre r.a..

<sup>14</sup> Shënon Tirmidhiu nga Ebu Kebsha Enmari, me fjalë të përafërta, dhe thuhet që është hasen-sahih.

## ***Fjalët e të mëdhenjve të islamit në këtë çështje***

Llokman Hakimi, e këshilloi të birin:

*“Evlad, mbrohu nga fukarallëku me fitim hallall.*

*Sepse njeriun fukara e godasin tri fatkeqësi:*

*- i dobësohet besimi (sepse fukarallëku e tërheq njeriun në të këqija);*

*- i ligështohet mendja (sepse mendimi për kushtet të jetesës e huton njeriun); dhe*

*- e humb dinjitetin; (më e rënda - njerëzit e tallin).*

Omeri r.a., ka thënë:

*“Asnjëri prej jush mos ta braktisë kërkimin e riskut e të thotë: ‘O Allah, më sjell riskun tim.’ Ju e dini mirë se ari e argjendi nuk bien nga qielli.”*

Zejd b. Mesleme po mbillte fidane në tokën e vet, e Omeri r.a., i tha:

*“Punë të mirë po bën. Nëse bëshesh i pavarur nga njerëzit, edhe ruan besimin edhe bëshesh fisnik. Miku ynë Uhajja b. Xhulah ka thënë:*

*- Unë vazhdimisht ujis fidanet në Zevra (lagje në Medine), sepse ndaj miqëve, fisnik mund të bëhet vetëm ai që është i pasur.”*

Ibn Mesud r.a., ka thënë:

*“Vërtetë nuk më pëlqen kur shoh njeri të pa punë, që nuk punon as për dynjallëkun e as për ahiretin e vet!”*

E kanë pyetur Ibrahim Nehain:

*- Sipas jush, a është më i vlefshëm tregtari i ndershëm apo ai që është dhënë pas ibadetit?,*

e Ibrahim u përgjigj:

*- Sipas meje, më i vlefshëm është tregtari (besimtar) i ndershëm. Sepse tregtari është gjithmonë në gjendje lufte me shejtanin - deri sa matë, merr dhe shet.*

Por Hasan Basriu e ka kundërshtuar këtë mendim.

Omeri r.a. një herë ka thënë:

*“Vendi ku më së shumti kisha dashtë që të më arrijë vdekja do të ishte vendi ku bëj tregti, ku blej e shes për familjen time.”*

Hesejm b. Xhemili ka thënë:

*“Nganjëherë më arrin ndonjë fjalë e shëmtuar që dikush e thotë për mua, e kjo më rëndon, por kur kujtohem se nuk varem nga ai person, nuk u jap rëndësi fjalëve të tij.”*

Ejub b. Temime Sahtijani ka thënë:

*“Për mua, më i dashur është fitimi i pakët e hallall, sesa fitimi i shumtë me lypësari.”*

Njëherë, Ibrahim Ed’hemi ishte duke udhëtuar me anije dhe papritur, filloi furtunë. Ata që ishin në anije thanë:

- *Çfarë tmerri i madh është ky!*, e Ibrahim tha:

- *Kjo nuk është asgjë, tmerr i vërtetë është kur varesh nga njerëzit.*

Ejub b. Temime Sahtijani tregon se Ebu Kulabe i ka thënë:

*“Merru me tregti, shko në çarshi dhe kërko punë, shpëtimi është në pavarësinë prej njerëzve.”*

E kanë pyetur Ahmed b. Hanbelin:

- *Çka mendon për atë që rri në shtëpinë e vet a në xhami, e thotë: ‘Nuk do të punoj, sepse risku im do të më vijë vet’*”, e ky u përgjigj:

- *Ai është injorant dhe i mjerë. A nuk i ka dëgjuar ai fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:*

***“Vërtetë Allahu Teala më ka dhënë riskun tim në hijen e shtizës time!”<sup>15</sup>***

---

<sup>15</sup> Shënon Ahmed i nga Ibn Omeri r.a..



Njëherë, kur Resulallahut s.a.v.s., ia përmendën zogjtë, ai tha:

**“Shpendët fluturojnë në mëngjes të uritur e kthehen në mbrëmje të ngopur.”<sup>16</sup>**

As’habët e Resulallahut s.a.v.s., janë marrë me tregti, në tokë e në det, e i kanë punuar edhe fushat e hurmeve.

Pra, ata duhet t’i marrim shembull.

Ebu Kilabe i tha një personi:

*“Më e dashur më është kur të shoh duke siguruar kushtet e jetesës, se sa të të shoh në një qoshe të xhamisë.”*

Tregohet se Evzai e takoi një ditë Ibrahim b. Ed’hemin me një ngarkesë dru në shpinë, e i tha:

- *O Ebu Is’hak, deri kur do të bartësh dru? Vëllezërit e tu mund të kujdesen për ty,*

e Ibrahim i u përgjigj:

- *O Ebi Amr! Mos fol kështu, sepse kam dëgjuar që nëse personi duron poshtërimin në kërkim të fitimit hallall, do të hyjë në xhenet.*

---

<sup>16</sup> Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Omeri r.a.

Ebu Sulejman Darani ka thënë:

*“Sipas nesh, ibadet nuk do të thotë që vazhdimisht të falet namazi e dikush tjetër t’i siguron kushtet e jetesës. Siguroja një herë ushqimin vetes, e më pas bëj ibadet.”*

Muadh b. Xhenbeli r.a., ka thënë:

*“Në Ditën e Gjykimit, një tellall do të thërrasë: ‘Ku janë ata në tokë që Allahu Teala nuk i do?’, e do të ngriten ata që kanë kërkuar lëmoshë nëpër dyert e xhamive.”*

Pra, sheriatu nuk pranon lypësinë dhe mbështetjen në furnizim nga tjetri. Kush nuk ka pronë të trashëguar, nga lypësaria mund ta shpëtojë fitimi dhe tregtia hallall.

Nëse ti pyet: *“E si pra Resulallahu s.a.v.s., thotë:*

***Mua nuk më është shpallur: ‘Mbledh pasuri’, as: ‘Bëhu tregtar’, por më është shpallur: ‘Me falënderim bëji tesbih Rabit tënd’,***

*dhe:*

***‘Bëhu njëri nga ata që bëjnë sexhde’***

*si edhe:*

***‘Bëji ibadet Rabbit tënd, deri sa të vijë vdekja’<sup>17</sup>,***

---

<sup>17</sup> Ibn Merduvejh nga Ibn Mesud r.a.

*dhe, kur kërkuan këshillë nga Selman Farisi, ai tha:*

*“Le t’ju gjejë vdekja deri sa jeni në haxh, ose në luftë, ose në xhami dhuke bërë ibadet, por kurrsesi të mos ju gjejë vdekja duke bërë tregti apo duke mashtruar?”*,

kësaj dileme tëndes i përgjigjem kështu:

Për të kuptuar këto transmetime që në shikim të parë kundërshtojnë njera-tjetrën, duhet shpjegim i hollësishëm.

Nuk po themi që tregtia në përgjithësi, është më e vlefshme se veprimtaritë tjera. Megjithatë, tregtia është rrugë që të fitohet aq sa është e domosdoshme, ose edhe të arrihet bollëku, ose edhe të fitohet shumë më tepër. Nëse dikush e ka për qëllim që me tregti të arrijë shumë më tepër se sa që e i nevojitet, që pasurinë të mund ta grumbullojë dhe ta ruajë duke mos dashur ta harxhojë në bamirësi ose ta ndajë si sadaka, atëherë një tregti e tillë nuk është e pëlqyer, sepse paraqet kthim kah dynjallëku, e dashuria ndaj dynjasë është burim i të gjitha gjynaheve. E nëse në tregti bën padrejtësi dhe mashtron, atëherë bëhet zullumqar edhe gjynahqar.

Pra, ky është qëllimi i Selmanit kur thotë:

*“Kurrsesi të mos ju gjejë vdekja duke bërë tregti apo duke mashtruar.”*

Me *'tregti'*, këtu ai ka menduar në tregtinë e atij që ka për qëllim të arrijë shumë më tepër pasuri se sa që i duhet - që pasurinë të mund ta grumbullojë dhe ta ruajë duke mos dashur ta harxhojë në bamirësi ose ta ndajë si sadaka.

Por, nëse me tregti ai synon aq sa t'i mjaftojnë atij dhe familjes së tij, e këtë do të mund t'a arrinte edhe duke zgjatur dorën, atëherë më mirë të merret me tregti se sa të bëhet lypës. Nëse nuk i duhet të bëhet lypës pasi që njerëzit vet i japin dhurata, prapë e ka më mirë të punojë; njerëzit po i dhurojnë për shkak që situata e tij e imponon lypësinë dhe pse ai ua bën me dije njerëzve që është fukarâ. Bile, në situata të tilla, angazhimi me tregti është më i mirë se sa angazhimi me ibadete trupore.

Braktisja e tregtisë është më e mirë për katër kategori njerëzish:

- 1.Për abidët të angazhuar me ibadete trupore;
- 2.Për ata që merren me punë të lidhura me anën shpirtërore, që janë në udhëtim të brenshëm për të njohur të fshehtat dhe gjendjet e zemrës;
- 3.Për dijetarët që merren me dituritë zahir për t'ju shërbyer njerëzve në besimin e tyre, siç janë myftiu, mufessiri, muhaddithi e të ngjashëm; dhe
- 4.Për ata që merren me punët e popullit, siç janë sulltani, kadia, e të ngjashëm.

Nëse këto katër kategori njerëzish mund të mbulojnë nevojat e tyre të domosdoshme për jetë nga paratë e ndara për punët e rëndësishme publike, ose nga vakëfi, për ta është më mirë të merren me punët që i kanë marrë përsipër se sa me tregti.

Për këtë arsye i është shpallur Resulallahut s.a.v.s.:

***Me falënderim bëji tesbih Rabbit tënd!,***

dhe:

***Bëhu njëri nga ata që bëjnë sexhde!,***

e nuk i është shpallur:

***Bëhu tregtar.***

Sepse Resulallahu s.a.v.s., në vete i ka bashkuar të katër veçoritë që i përmendëm, bashkë me plot tjera që nuk mund të përshkruhen.

Gjithashtu, kur Ebu Bekr r.a., u zgjodh halife, as'habët i thanë t'a braktisë tregtinë, sepse tregtia do t'i dëmtonte angazhimin në punët e shoqërisë. Ai merrte pagesë nga paratë e dedikuara për atë qëllim, dhe besonte që puna e halifes është më e rëndësishme. Në *vasijjet* (porosinë e fundit), ka urdhëruar që ato mjete të kthehen në *bejtulmal* (thesari i shtetit), ani pse në fillim e shihte si të drejtë që t'i marrë.

Për këto katër kategori njerëzish ka dy situata:

**Situata e parë** është rasti kur nuk kërkojnë, e kushtet e nevojshme të jetesës i sigurojnë nga zeqati dhe sadaka që njerëzit vet e japin.

Në këtë rast, për ta është më mirë të braktisin tregtinë e të merren me atë që e kanë obligim, sepse i ndihmojnë njerëzit në bërjen e veprave të mira, dhe bëjnë atë që për ta është më e vlefshme.

**Situata e dytë** është rasti kur ata, për të vazhduar detyrat e cekura më lartë, detyrohen në lypësari për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës.

Këtë duhet shqyrtuar mirë. Shpjegimet që i përmendëm më lartë kundër të kërkuarit lëmoshë janë udhërrëfyes për këto katër kategori njerëzish se a është më e përshtatshme për ta të braktisin lypësin dhe detyrën, e të kërkojnë rrugët për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës.

Është shumë e vështirë të merret qëndrim i përgjithshëm për këtë çështje, pa i marrë parasysh edhe situatat e caktuara dhe rastet e veçanta të tyre.

Personit i mbetet që vet të analizojë dhe të vlerësojë për vete, duke e krahasuar përlujtjen e mundshme, rrënimin e dinjitetit dhe nevojën që

dikujt t'i bëhet i mërzitshëm - në çka do të hasë kur kërkon mjete nga njerëzit - me dobitë eventuale për vete dhe të tjerët që mund t'i sjellë angazhimi i tij me dituri dhe me veprimtaritë e cekura.

Mund të ndodhë që në angazhimin e dikujt me këto punë të ketë dobi të madhe edhe për të edhe për të tjerët, kështu që lehtë dhe me pak ekspozim lypjes arrin te mjetet e nevojshme, por mund të ndodhë edhe e kundërta.

Mundet gjithashtu të ndodhë që e dëshiruara dhe e padëshiruara domosdo të jenë të kundërta mes vete, e atëherë personi duhet kërkuar zgjidhje në zemrën e vet, edhe nëse i ka përgjigjet nga myftiu, sepse fetvatë nuk përfshijnë veçoritë e rëndësishme të situatave të caktuara.

Në gjeneratat e mëhershme ka edhe të tillë që kanë pasur nga treqind e gjashtëdhjetë shokë, ashtu që çdo natë të vitit e kalonin te ndonjëri prej tyre. Të tjerët i kanë pasur nga tridhjetë, e çdo muaj e kalonin te ndonjëri prej tyre.

Pra, këta ishin të angazhuar vetëm me ibadet dhe e dinin se shokëve të tyre nuk u vjen vështirë të

kujdesen për ta. Ata në këtë mënyrë kanë siguruar kushtet e jetës, dhe me pranimin e gostitjes së shokëve kanë vlerësuar që edhe shokët e tyre marrin pjesë në sevapin e ibadetit të tyre.

Prandaj duhet pasur shumë kujdes në këto çështje. Shpërblimi për atë që pranon është i barabartë me shpërblimin e atij që jep, përderisa ai që pranon me këtë e ndihmon fenë, e ai që jep - jep nga zemra.

Ata që i kuptojnë këto shpjegime tona, pasi të mendojnë mirë sipas gjendjes së vet se cila kategori është më e mirë për ta, atë edhe e preferojnë.

Ishin këto disa fjalë lidhur me fitimin.

E marrëveshja e tregtisë duhet të përmbajë katër elemente: korrektësinë, drejtësinë, bamirësinë dhe kujdesin për fenë. Për secilën do ta lidhim nga një kapitull. Në kapitullin e dytë do të fillojmë me përshkrimin e kushteve për korrektësinë.



## Kapitulli i dytë

### KORREKTËSIA E KËMBIMT NË TREGTI

Për çdo mysliman që merret me shitblerje është farz të mësojë këtë dituri, sepse

**“Të mësuarit (dituri) është farz për çdo mysliman.”**

Për myslimanin është farz të mësojë diturinë që atij i nevojitet. Ai që merret me shitblerje sigurisht që ka nevojë për diturinë e tregtisë.

Kur i mëson çështjet në lidhje me tregtinë, atëherë i njeh këmbimet me telashe dhe largohet prej tyre. Mund të ndodh që nuk i di detajet e ndonjë çështje të rrallë, e edhe ato i mëson duke pyetur.

Por nëse nuk i posedon njohuritë e përgjithshme për çështjet kryesore, atij nuk i bie ndër mend të pyes për detaje të tilla, e as nuk di çka të pyes.

Kush thotë:

*- Nuk dua të mësoj para kohe; do të kërkoj zgjidhje kur të lajmërohet problemi”, e pyesim:*

*- Si do ta dish se është lajmëruar problemi, kur nuk i njeh çështjet kryesore të tregtisë?”*

I tilli vazhdon me të veten, duke e konsideruar të drejtë e të lejuar.

Për këtë arsye Omeri r.a., kur vizitoi pazarin, i goditi me shkop disa tregtarë, duke thënë: “*Në pazarin tonë shitblerje le të bëjnë vetëm ata që i njohin mirë rregullat e shitblerjes, përndryshe do ta ‘hani’ kamatën, me apo pa vetëdije!*”

Njohuritë rreth tregtisë janë të shumta, mirëpo tregtarit domosdo i duhen njohuritë për këto gjashtë çështje: për shitblerje (*bej*), kamatë (*riba*), *selem*<sup>18</sup>, qira (*ixhare*), *kirad*<sup>19</sup> dhe ndërmarrje. Tani t’i sqarojmë kushtet e tyre:

### Marrëveshja e parë MARRËVESHJA PËR SHITBLERJE

Allahu Teala e ka bërë shitblerjen hallall, e kamatën e ka bërë haram. Ekzistojnë tri kushte për korrektësinë e marrëveshjes në shitblerje:

1. Marrëveshja mes shitësit dhe blerësit;
2. Përmbajtja e marrëveshjes;
3. Vërtetimi i marrëveshjes.

**Kushti i parë:** marrëveshja mes shitësit dhe blerësit.

Tregtari nuk duhet të bëjë marrëveshje për shitblerje me të miturin, me të çmendur, me skllavin dhe me të verbrin.

---

<sup>18</sup> Pagesa e parakohshme

<sup>19</sup> Tregtia me kapital të huaj, me hise në fitim

I mituri është pa përgjegjësi, e njëjtë edhe i çmenduri. Marrëveshja për shitblerje me ta është e pavlefshme.<sup>20</sup> Imam Shafiu mendon se me të miturin nuk duhet bërë marrëveshje për tregti, edhe nëse babai (kujdestari) i tij e lejon. Çkado që të merr prej tyre, do të duhet ta kompenzojë, por çkado që ju jep miturit dhe çmendurit, e ajo humbet a shkatërrohet në duart e tyre, tregtari vet e mban përgjegjësinë.

Marrëveshja me një skllav të kuptueshëm është e vlefshme vetëm me lejimin e pronarit të tij, në të kundërtën nuk është e vlefshme. Për këtë arsye pemëshitësi, bukëpjekësi, kasapi e të tjerë nuk tregtojnë me skllavë, derisa pronarët e tyre ta lejojnë këtë, dhe kjo ashtu që tregtari e dëgjon vet dhënien e lejes direkt nga pronari i skllavit, ose është gjerësisht e njohur në atë vend se filan skllavi e ka lejen për shitblerje në emër të pronarit të tij, prandaj tregtari do të mbështetet në këtë, ose në fjalën e ndonjë njeriu të drejtë, që do ta informonte për të.

Nëse skllavi nuk e ka lejen e pronarit e tregtari bën shitblerje me të, kjo shitblerje nuk është valide. Në atë rast tregtari do të ishte i obliguar t'ia kthejë

---

<sup>20</sup> Sipas Hanefive, nëse shitblerja bëhet nga i mituri që është në gjendje të dallojë fitimin dhe dëmin, korrektësia e kësaj shitblerje është e lidhur me lejen e babait të tij. Nëse babai i tij lejon, shitblerja është e drejtë. Nëse babai i ka dhënë leje atij më parë, edhe marrëveshja me tregtarin për shitblerje është e pranueshme.

pronarit mallin që e ka marrë nga skllavi, përderisa për mallin që i ka dhënë skllavit, e ai mall të dëmtohet a humbet, nuk do të mund ta kërkojë kompensim, as nga skllavi e as nga pronari.

I mbetet vetëm mundësia që mallin ta kërkojë nga skllavi në rast se ky bëhet njeri i lirë.

E sa i përket të verbërit: i verbri mund të shesë e blejë mallin që nuk e sheh, por një shitblerje e tillë nuk është valide. Të verbrit do t'i kërkohet t'i japë autorizimin dikujt që sheh, e që në emër të të verbrit do të bënte tregti. Tregtia me të verbriin pa prezencën e personit të autorizuar nga i verbri, është e pavlefshme. Tregtari do të duhet ta kthente atë që e ka marrë dhe atë që ia ka dhënë të verbrit, në vlerë të njëjtë.<sup>21</sup>

Marrëveshja e tregtisë me jobesimtar është valide, por jobesimtarit që nuk jeton mes myslimanëve nuk duhet t'i shitet mus'hafi, skllavi mysliman dhe armët. Nëse tregtari megjithatë do ta bënte këtë, një marrëveshje e tillë konsiderohet e papranueshme dhe tregtari është gjynahqar.

---

<sup>21</sup> Sipas Imam Ebu Hanifes, Imam Malikut dhe Imam Ahmedit, nëse të verbrit i tregohet si duhet cilësia e mallit, shitblerja është e vlefshme.

Sa u përket ushtarëve turq, turkmenë, arabë e kurdë, pastaj hajnave, mashtruesve, fajdexhinjëve e dhunuesve, si edhe të gjithëve, shumica e mallit e të cilëve është haram, nga ta nuk duhet marrë asgjë, sepse bëhet fjalë për haram, përpos nëse tregtari e di sigurtë për diçka të caktuar që e merr nga ta, se nuk është haram. Për këtë do të ketë më shumë fjalë në *Librin për hallallin dhe haramin*.

**Kushti i dytë:** përmbajtja e marrëveshjes.

Ky është malli që shitet e blehet, qoftë të jetë shitje me para ose shkëmbin për baraz-vlerën e mallit. Edhe në këtë kërkohen gjashtë kushte:

1. Malli të mos të jetë i papastër për nga natyra.

Prandaj nuk është e drejtë të shitet qeni<sup>22</sup>, derri, bërllogu, jashtëqitja, bajga e kafshës<sup>23</sup>, ashti dhe fildishi, si dhe enë të bëra prej saj; ashti i kafshës së ngordhur është i papastër. Elefanti, edhe po të therrej sipas rregullave, nuk mund të jetë i pastër, e me vdekje papastërtia kalon edhe në eshtra. Me larje, papastërtia nuk zhduket<sup>24</sup>.

---

<sup>22</sup> Imam Ebu Hanife e lejon shitblerjen e qenit, mosmarrëveshja është për qentë e egër/agresivë.

<sup>23</sup> Sipas Imam Hanefisë, shitblerja e bajgës është e lejuar nëse nga ajo përfitohet në prodhim. Edhe shitblerja e qimes së derrit për qepje të këpucës është e lejuar.

<sup>24</sup> Sipas Hanefive ashti dhe dhëmbët e parë të elefantit (fildishi) është i pastër dhe me përpunimin e lëkurës (regjja e lëkurës), edhe lëkura pastrohet.

Edhe shitja e alkoolit është e papranueshme, si edhe yndyra e papastër e kafshëve që nuk i hamë, ani pse ajo yndyrë është e mirë për ndriçim ose për lyerje të anijes.

E pranueshme është të shitet vaji i cili sipas natyrës është i pastër, por është bërë i papastër pasi në të ka rënë ndonjë ndytësi, apo ka ngordhur ndonjë mi në të. Vaji i këtillë nuk mund të përdoret për ushqim, por mund të përdoret për qëllime tjetra, sepse ai nuk është i papastër në natyrën e vet.

Nuk e konsideroj gjynah të shiten vezët e krimbit të mëndafshit, sepse nga to dalin kafshë të dobishme. Është më e drejtë t'i krahasojmë ato me vezët e pulës.

Është e lejuar të shitet lëvozhga e miskut<sup>25</sup>, nëse është marrë deri sa gazela ka qenë ende gjallë.

## 2. Malli të jetë fitimprues.

Nuk lejohet shitja e insekteve, minjëve apo gjarprinjëve, pa marrë parasysh që ato i përdorin magjistarët dhe argëtuesit e rrugëve duke i joshur me muzikë nga shportat e duke bërë shfaqje.

Është e lejuar të shiten macet, bletët, macja e egër ose luani, si edhe kafshët që mund të përdoren

---

<sup>25</sup>Aromë e mirë, që del nga gjëndra nën lëkurë në pjesën e barkut të gazelës mashkull që jeton në malet e Asisë.

në gjueti, ose që mund t’u përdoret lëkura, e lejohet edhe shitja e elefantit, për transport.

Lejohet edhe shitja e papagajve, palloit, dhe shpezëve tjerë me pupla të bukura, sepse kënaqja me zërin dhe dukjen e tyre është *mubah*. Nuk është e lejuar të mbahet qeni me qëllim që të kënaqemi me paraqitjen e tij, sepse këtë e ka ndaluar Resulallahu s.a.v.s.<sup>26</sup>.

Nuk lejohet shitja e udit, gajdes, fyellit dhe instrumenteve tjera muzikore, sepse sipas shariatit, nga to nuk ka dobi. Njëjtë është me figurat e punuara nga argjila, siç janë figurat që u shiten si lodra fëmijëve gjatë festave - këto duhet të thehen.

Lejohet të shiten vizatime në letër me lule ose pamje me drunjë, lejohen edhe rrobat dhe enët në të cilat janë vizatuar kafshë, e njëjtë edhe për perde e paravanë. Për një copë të tillë, Resulallahu s.a.v.s., i tha Ajshes r.anha:

**“Bëj jastëkë prej saj.”<sup>27</sup>**

3. Malli në shitje të jetë në pronësi të palës në marrëveshje, ose të posedohet leje nga pronari.

Nuk duhet blerë nga ai që nuk posedon lejen e pronarit, por duhet pritur leja (e pronarit). Nëse

---

<sup>26</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ibn Omeri r.a.:

**“Kush mbanë qen tjetër pos për çobani ose gjueti, vepra e tij do të zvogëlohet për çdo ditë nga dy kiratë (një kirat ka peshën e malit Uhud).”**

<sup>27</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ajsha r.anha.

bëhët shitja, kjo shitje është e papranueshme. Bile, edhe nëse pronari më pas pajtohet me të, shitja duhet përsëritur.

Nuk duhet blerë duke supozuar miratimin e tjetrit: nga gruaja mallin e burrit të saj, e as nga burri mallin e gruas së tij, nga prindi nuk duhet blerë mallin e fëmijëve të tyre, e as nga fëmijët mallin e prindërve të tyre.

Që shitblerja të jetë e vlefshme, fillimisht duhet pajtuar për atë. Njëjtë është edhe për shitblerjen në pazare, prandaj ai që kujdeset për besimin e vet, do të duhej të jetë i vëmendshëm.

4. Dorëzimi i mallit që shitet duhet të jetë i mundshëm, edhe fizikisht edhe sipas shariatit.

Nuk është e drejtë të shitet ajo që fizikisht nuk është e mundur të dorëzohet. Për shembull, skllavi i arratisur: edhe pse sipas shariatit ai është mall i pronarit të vet, fizikisht nuk është malli i tij. Megjenëse dorëzimi i mallit (skllavit) nuk është i mundur deri sa skllavi është në arrati, shitblerja nuk është e drejtë.

Nuk është e pranueshme as shitblerja e peshkut në ujë, shpendit në ajër, këlyshit në bark, farës së mashkullit, leshit të paqethur dhe qumështit në gji, sepse dorëzimi i tyre nuk është i mundur.



Nuk është e pranueshme të shitet as ajo që nuk mund të dorëzohet sipas shariatit, siç është hipoteka, vakëfi dhe skllavja shtatzënë nga pronari, sepse do të lirohet.

Nuk është e pranueshme të shitet as nëna skllave që ka fëmijë të vogël, e të shitet pa fëmijën e saj, ose fëmija pa nënë, ndarja e tyre është haram.

5. Mallit në shitje t'i përcaktohet veçoria, sasia dhe cilësia.

Përcaktimi i veçorisë nënkupton që shitësi të tregojë saktë se cilin mall po e shet. Pra, kur thotë: *“po të shes dele”*, duket të tregojë delen, ose nëse shet rroba, duhet të tregojë rrobën që shitet.

Nëse shitësi thotë: *“Po të shes cilën do dele nga kjo tufë dhenësh”*, ose *“një komplet nga rrobat që i ke përpara”* ose *“një copë të kësaj pëlhure”* ose *“dhjetë metra katror të kësaj toke”*, një shitblerje e tillë nuk do të ishte e lejuar<sup>28</sup> sepse përcaktimi është kusht. Ashtu veprojnë ata që nuk janë të vëmendshëm për fenë e tyre.

Përrjashtim bën rasti kur shitet një pjesë e përcaktuar e një tërësie të njohur, sikur kur shitet *gjysma* e diçkaje apo *një e dhjeta* pjesë e saj; atëherë shitblerja lejohet.

---

<sup>28</sup> Sipas Imam Hanefisë, shitjet e tilla janë të pranueshme.

Përcaktimi i sasisë bëhet me matje, peshim ose me shikim. Nëse shitësi thotë: *“po t’i shes këto rroba për çmim të njëjtë me të cilin edhe filani i ka shitur rrobat e tij”*, e as shitësi as blerësi nuk e dinë se çfarë çmimi kanë qenë ato rroba, një shitblerje e tillë nuk lejohet.

Edhe nëse do të thoshte: *“po të shes këtë mall, në peshë të njëjtë të kësaj mase”* e pesha e asaj mase nuk dihet, as kjo shitje nuk do të ishte e lejuar.

Edhe nëse thotë: *“po të shes këtë grumbull grurë”*, nuk do të ishte shitje e lejuar.

Por nëse thotë: *“po të shes këtë mall për para”*, ose *“...për këtë copë ari”*, e blerësi e sheh copën e arit dhe sasinë, atëherë shitblerja do të ishte e lejuar, sepse vlerësimi përmes shikimit do t’i mjaftonte në përcaktimin e vlerës.

Përcaktimi i cilësisë bëhet edhe përmes shikimit të mallit që blehet. Nuk lejohet shitja e mallit që nuk shihet në vendin ku bëhet shitblerja, pos nëse është parë para aq kohe sa nuk ka mundur t’i ndodhë ndonjë ndryshim i rëndësishëm.

Përshkrimi i mallit nuk mund të zëvendësojë të shikuarit e tij. Nuk lejohet shitja e pëlhurës vetëm në bazë të sasisë e pëlhura është ende duke u thurur, e as i drithit që është ende në arë.<sup>29</sup>

Orizi duhet shitur në lëvozhgën e vet, ku edhe ruhet. Njëjtë vlenë edhe për shitjen e arrave dhe bademit me lëvozhgën e poshtme, por jo edhe me të dy pjesët e lëvozhgës. Shitja e bizeles së freskët me të dy pjesët e lëvozhgës është e lejuar, nëse për këtë ekziston nevoja.

Lejohet edhe shitja e lëngut të rrushit në shishe të mbyllur. Sepse kur hapet shishja, ekziston rreziku që lëngu i rrushit të priset. Kjo është si shitja e shegës, që shitet vetëm me copë dhe, jo të hapura. Por edhe për këtë ka tolerancë. E nëse dikush e blenë (lëngun e rrushit) me qëllim që ta shes tutje, kjo nuk do të ishte e drejtë.

## 6. Malli i shitur duhet të dorëzohet.

Ky është kusht i veçantë sepse:

*“Resulallahu s.a.v.s., na ka ndaluar shitjen e asaj që nuk është dorëzuar.”*<sup>30</sup> (do të thotë: malli i shitur që nuk i është dorëzuar blerësit, nuk mund t’i shitet tjetrit).

---

<sup>29</sup> Sipas Imam Hanefisë, kur drithi piqet e bëhet grurë, shitja është e pranueshme. Edhe Imam Shafiu është i të njëjtit mendim.

<sup>30</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ibn Abbass

Kjo vlenë edhe për pasurinë e luajtshme, edhe për patundshmëritë. Pa dorëzimin e mallit, marrëveshja në princip nuk është valide. Pasuria e luajtshme merret me dorëzim, kurse patundshmëria me lirim e saj dhe vendosjen në dispozicion të saj për pronarin e ri. Edhe malli që matet, ose që shitet me copë, dorëzohet pas matjes (ose numërimit). Blerja e pronës së trashëguar, amanetit dhe pronës nga depozita, si edhe pronës që nuk është marrë në pronësi përmes pagesës, lejohet, edhe para marrjes së saj.

**Kushti i tretë:** vërtetimi i marrëveshjes, do të thotë fjala që garanton shitjen.

Duhet së bashku të thonë *“po e shes”* dhe *“po e pranoj.”* Pikërisht kështu, duhet të shprehet me fjalë të qarta ose me shenjë që nënkupton qëllimin e njëjtë.

Nëse thotë: *“të jap këtë”* në vend të: *“po të shes”* dhe pala tjetër thotë: *“pranoj!”*, shitblerja do të ishte e vlefshme vetëm nëse të dy palët me këtë nënkuptojnë shitjen, sepse një shprehje e tillë mund të nënkuptojë edhe mundësinë e dhënies në hua. Shprehja haptas dhe e qartë e qëllimit largon mosmarrëveshjen në mënyrë më të sigurt. Por, sipas marrëveshjes, edhe me aluzion mund të tregohet prona e shitur dhe ligjshmëria e asaj shitje.

Nuk është e drejtë që të shtohet më vonë ndonjë kusht, që nuk do të përshtatej me detajet e marrëveshjes. Nëse për shembull, blerësi do të kushtëzonte që mallit të blerë t'i shtohet edhe diçka, ose që malli i blerë t'i dorëzohet në shtëpi, kjo do ta anulonte marrëveshjen, përpos nëse më parë nuk ka caktuar edhe një shumë për bartje, krahas shumës për mallin.

Nëse mes shitësit dhe blerësit nuk ka asnjë shkëmbim fjalësh, e shitblerja bëhet vetëm me dhënie dhe marrje, një shitblerje të tillë sipas Imam Shafiut nuk konsiderohet e lejuar. Për Ebu Hanifen kjo mund të pranohet, nëse bëhet fjalë për gjëra që kanë vlerë të vogël.

Megjithatë, është shumë e vështirë të përcaktohet se cilat janë ato gjëra.

Nëse shikojmë se si e trajtojnë këtë çështje traditat, shohim se njerëzit këtë kryesisht e pranojnë si të lejuar.

Shembull: ndërmjetësi në shitje shkon te shitësi i basmasë, merr nga ai rrobat e mëndafshit, vlera e të cilave është, themi - dhjetë dinarë, dhe ia dërgon ato rroba myshteriu. Myshteriu pajtohet dhe ia jep ndërmjetësit dhjetë dinarë. Ky i merr paratë nga myshteriu, ia dërgon shitësit, e ky i merr dhe tash janë të tij. Myshteriu pra bleu rroba, e në mes të shitësit e blerësit nuk kishte asnjë shkëmbim fjalësh.

Ose për shembull, në ankand ku tregohet malli që ka vlerë, themi - njëqind dinarë, dhe garimi fillon. Njëri ofron nëntëdhjetë dinarë, tjetri nëntëdhjetë e pesë, i treti njëqind, dhe mallin e blen personi që jep njëqind dinarë, e edhe kjo është pa ofertë dhe pranim mes pronarit të mallit dhe blerësit. Njerëzit kanë vazhduar të veprojnë kështu, sipas traditës. Problemet e këtilla janë si sëmundja kronike që nuk pranon ilaç. E në këtë çështje ka tri mundësi:

**Mundësia e parë:** të hapet dera e shitjes dhe blerjes pa asnjë fjalë goje, pa ndërmjetësues - si për gjëra që kanë pak vlerë, si për gjëra të shtrenjta - e kjo është e pamundur, sepse kjo do të ishte kalim i pronësisë prej njërit te tjetri pa asnjë fjalë që e tregon dhe dëshmon këtë kalim pronësie.

Allahu Teala e ka bërë hallall shitblerjen, e shitblerja përbëhet prej ofertës dhe pranimit (të asaj oferte).

Nëse nuk është folur për ofertën dhe pranimin, kësaj nuk i thuhet shitblerje. Si mundet që, pa asnjë fjalë, pasuria e një personi, skllavi i tij, shtëpia, kali e gjëra rreth të cilave shpesh ka mosmarrëveshje, të kalojë te tjetri?

Personi që e dorëzon mallin e vet pa asnjë fjalë, ka të drejtë ta ndërrojë mendjen më vonë e të thotë: *“Jam bërë pishman! Zaten shitje nuk bëra, asgjë nuk thash, e dorëzova mallin dhe tani po e marr; kjo nuk ishte shitje.”*

**Mundësia e dytë:** të mbyllet dera e shitjes dhe blerjes me dorëzim dhe pranim - si për gjëra që kanë pak vlerë, si për gjëra të shtrenjta, duke e zbatuar strikt qëndrimin e Imam Shafiut që një shitblerje e tillë nuk lejohet.

Por, edhe këtu ka vështirësi nga dy drejtime:

E para, tradita e shitblerjes pa ofertë e pranim të shprehur për gjëra me vlerë të vogël është e pranishme qysh nga kohët e as’habëve. Sikur ata të kushtëzonin në atë kohë blerjen e ushqimit, ose blerjet në furrë e mishtore me marrëveshje, kjo do t’ju vështirësonte punët. Po të kishte një kushtëzim të tillë, kjo do të na ishte e njohur, dhe do ta dinim edhe kur kanë hequr dorë nga një praktikë e tillë. Por kjo gjendje ndryshoi me kohë.

E dyta: njerëzit tashmë janë adaptuar plotësisht në këtë. Kushdo që blenë ushqim dhe gjëra të ngjashme të nevojshme, është i vetëdijshëm që shitësi atë lloj malli e shet me mënyrën e dhënies-marrjes, ashtu që, në këtë situatë, çfarë dobie kanë fjalët?

**Mundësia e tretë** është që malli të klasifikohet në dy kategori: *‘Më pak të vlefshme’* dhe *‘Të tjerat’*, sipas qëndrimit të Ebu Hanifes.

Në atë rast do të ishte shumë e vështirë të precizohet se cili mall është më pak i vlefshëm, e mbetet edhe problemi i definimit të mënyrës së kalimit të mallit në pronësi të tjetrit, pa fjalë, siç u shpjegua.

Ibn Surejxh e ka pranuar qëndrimin e Shafiut, duke e konsideruar si më të matur, e më pas edhe pohon se nuk do të gabonim nëse, në rast nevoje, edhe ne anojmë kah kjo anë, ashtu siç më së shpeshti veprojnë njerëzit, ose siç ka qenë qëndrimi më herët.

Ndërsa përgjigja për dy problemet nga mundësia e dytë është kjo:

a) Nuk është obligim i joni, e as mundësitë nuk na lejojnë, që të bëjmë ndarje precize të mallrave më pak të vlefshme nga të tjerat.

Këtu i kemi të qarta dy segmente:

E para, dihet haptas se sasia më e vogël e perimeve, pemëve, bukës dhe ushqimit, e cila blehet për çdo ditë, konsiderohet si mall më pak i vlefshëm.

Një shitblerje e tillë bëhet pa ofertë dhe pranim. Atë që pret ofertë dhe pranim nga ky lloj i tregtisë do ta konsideronin cikërrimtar, dhe vet një blerje e tillë do të ishte vështirë e realizuar. Ky segment është i qartë.



E dyta: mallërat si kafshët, skllavët, patundshmëritë dhe rrobat e shtrenjta konsiderohen mall tek të cilat kërkimi i ofertës dhe pranimit nuk paraqet ndonjë ngarkesë të veçantë. Është e qartë që çdokush e blen këtë mall me ofertë dhe pranim.

Megjithatë, mes këtyre dyjave, ka edhe mallra që në këtë aspekt llogariten si të padefinuara ose të paqarta. Këtu, besimtari është i obliguar të jetë veçanërisht i kujdesshëm, sepse, me shariat, edhe gjërat që bazohen në traditë ndahen në të lejuara e të ndaluara, si edhe të dyshimtat, mes tyre.

b) Problemi i dytë është kur, sepse për kalimin e pronës së njërit te tjetri kërkohet fjala e gojës. Ne, në vend kësaj mund të pranojmë sepse pranim-dorëzimin fizik.

Në fakt, fjala e thënë nuk është sepse në vetvete, por bëhet sepse meqenëse është shpjeguese. Ndërsa pranim-dorëzimi është sepse më i fuqishëm që në një mënyrë, vazhdimisht e shpjegon qëllimin.

Dëshmia më e qartë e kësaj është nevoja e domosdoshme, zakonet e paraardhësve si edhe tradita e vazhdueshme e marrjes së dhuratave, pa ofertë dhe pranim; sepse përcaktimi i vlerës në atë rast nuk bën ndonjë dallim. Megjithatë, edhe në bartje të dhuratës nevojitet dorëzimi i pronës.

Paraardhësit e kanë konsideruar sjellje të pahijshme kërkimin e ofertës dhe pranimit për dhuratë, pa marrë parasysh a është dhurata më pak e vlefshme apo e shtrenjtë. Por, në shitblerje për gjëra të shtrenjta, ofertën dhe pranimin e kanë konsideruar sjellje të hijshme.

E nga tri mundësitë që i shpjeguam, mendojmë se kjo është më e drejta.

Njeriu i ndershëm dhe besimtar që largohet nga harami nuk duhet të braktisë plotësisht ofertën dhe pranimin për të shpëtuar nga dyshimi, për mallin për të cilin nuk ka pajtim se a është me vlerë të vogël apo i shtrenjtë.

Nuk duhet ngurruar prej kësaj, për shembull, në situatën kur nuk dihet se si shitësi ka ardhë në pronësi të ndonjë malli: a e ka marrë pa ofertë e pranim të saj, ose me to. E nëse myshteriu ka qenë prezent në blerjen e atij malli, ose shitësi i mëhershëm i mallit qartas thotë: *“unë ia shita mallin këtij pa ofertë dhe pranim”*, atëherë myshteriu duhet të braktisë këtë shitës dhe të shkoj te tjetri.

Nëse bëhet fjalë për mall më pak të vlefshëm i cili nevojitet domosdo, e që të evitojë zënkën e mundshme në këtë, le ta aplikojë ofertën dhe pranimin, pasi që përgënjeshtrimi i fjalëve të qarta është i pamundur, kurse përgënjeshtrimi i aktit që nuk është përcjellur me fjalë të tilla, është i mundur.

Në rast se ti e parashtrosh pyetjen:

*“Nëse kjo mund të ndodhë gjatë blerjes së ndonjë malli, çfarë të bëjë njeriu kur është prezent në ndonjë sofër, dhe e di – ka dëgjuar ose vet e ka parë se nikoqiri, gjatë blerjes së ushqimit është limituar vetëm në marrëveshje joformale - a duhet hezituar nga ngrënia e ushqimit të siguruar në atë mënyrë?”*,  
unë do të përgjigjesha:

Ky mysafiri në sofër është i obliguar që të mos blejë prej tyre mallin e vlefshëm në atë mënyrë, por nuk është i obliguar që të hezitohet të hajë tek ta.

Unë vetëm dua të them se, fakti që jemi të pavendosur të veprojmë diçka nuk duhet të jetë arsye që të dyshojmë lejueshmërinë e atij akti. Çështja e lejueshmërisë është shumë më e gjerë se sa çështja e bazës për ndërrim të pronësisë.

Prandaj, për secilin ushqim për të cilin është e zakonshme që të shitet me marrëveshje joformale, dorëzimi nga ana e shitësit njëkohësisht është edhe leje që ai ushqim mund të hahet. Këtë e kuptojmë duke i krahasuar situatat. Kjo është si leja e hamamxhiut për hyrje në hamam. Prandaj, myshteriu mundet që me atë ushqim të ushqejë edhe tjetrin, sipas dëshirës. Kjo leje është në nivel të deklarimit të shitësit: *“po të lejoj që këtë ushqim ta hash ti, dhe që*

*me të të ushqesh kë të duash, sepse e ke hallall.”* Megjithatë, sikur shitësi haptas të thotë: *“ti mund ta hash këtë ushqim, por je i obliguar që më vonë të më japësh kundërvlerën”*, ai ushqim lejohet për t’u ngrënë, por qëndron edhe obligimi për të dhënë kundërvlerën e tij. Sipas mendimit tim, kjo është analogji e fikh-ut:

Pas marrëveshjes joformale, dikush e ka ‘ngrënë’ pronën e tjetrit dhe e ka harxhuar. Është i obliguar dhe e ka për detyrë, që këtë ta kompenzojë. Nëse e jep kundërvlerën e duhur, atëherë ai që kërkon kompenzim ka marrë atë që i takon, prandaj e drejta e pronësisë mund të kalohet, nëse pronari i mëhershëm nuk ka mundësi që ta kërkojë pronësinë prapë. E nëse e ka mundësinë, atëherë nuk ka bartje të pronësisë, sepse ai, ndoshta, nuk pranon që borxhi ashtu të paguhet. Atëherë është obligim të përsëritet procesi.

Në rastin për të cilin ne po flasim, ky e pranon obligimin, prandaj është e logjikshme që akti (i ngrënies) të merret si dëshmi e pranimi se borxhi do të kompenzohet, dhe që ky ta pranojë këtë si e drejtë e tij.

Gjendja e shitësit këtu është më e paqartë. Ai që është pronar i mallit, e dëshiron mallin në dispozicion. Nuk është e mundur të kalohet pronësia përderisa ushqimi te myshteriu nuk është hargjuar. Pastaj, ndoshta do të nevojitet të përtrihet qëllimi i bartjes së pronësisë. Pos kësaj, ekziston edhe mundësia e bartjes së pronësisë me vet aktin, pa deklaratimet e nevojshme.

Blerësi, si pala tjetër, vetëm dëshiron që ushqimin e blerë ta hajë. Atij kjo i është lejuar në bazë të krahasimit me situata të ngjashme. Megjithatë, përmes bisedës, mund të ndodh që mysafiri të jetë i obliguar të kompenzojë atë që e ka harxhuar. Ky obligim hiqet nga ai në rast se shitësi pranon në pronësi të tij atë që merr nga myshteriu. Kështu ai bëhet edhe personi që detyrohet me borxh, edhe personi që e paguan borxhin.

Ky është mendimi jonë sa i përket rregullave për marrëveshjen joformale, me gjithë komplikimet e saj, e Allahu Teala e di më së miri çka është e drejtë.

I kemi përmendur disa situata të supozuara në kuadër të cilave është e mundur të merret fetva vetëm për këto. E sa i përket besimtarit, ai do të kërkojë përgjigjen në zemrën e vet, e do t'i ikë gjërave të dyshimta.

## Marrëveshja e dytë

### MARRËVESHJA PËR KAMATËN

Allahu Teala e ka bërë kamatën rreptësisht haram. *Sarrafi*<sup>31</sup> që bën tregti me argjend dhe ari dhe personi që merret me shitblerjen e mallrave ushqimore duhet posaçërisht të largohen nga kamata, pasi që kamata është e lidhur kryesisht për para dhe artikuj ushqimor. Sarrafi duhet të ruhet nga kamata që bazohet në veresie (*nesi'e*) dhe në tepricë (*fadl*).

Kur flasim për ruajtje nga veresia, le t'i përdorin arin ose argjendin e pastër në shitblerje me produkte të njëjta, vetëm nga dora në dorë, dhe shkëmbimi le të jetë aty ku arrihet marrëveshja. Kështu këmbyesi ruhet nga veresia.

Rasti kur sarrafi dorëzon arin në punëtorinë e monedhave e nga ky ar të merr monedha ari, gjithashtu është haram i llojit të veresies, për shkak se në ato monedha në të shumtën e rasteve ka shtesë, sepse punëtorja nuk e jep sasinë e njëjtë të arit që e merr.

E sa i përket ruajtjes nga teprica (*fadl*), personi duhet të ruhet në tri raste:

---

<sup>31</sup> Sarraf: personi që punon me ari, argjend dhe para; këmbyses; argjendar; bankier.

1. Kur malli i dëmtuar (thyer) shkëmbehet për mall në gjendje të rregullt.

Kjo lejohet vetëm me kusht që pesha të jetë e njëjtë, nuk ka rëndësi a është malli i dëmtuar (thyer) apo në gjendje të rregullt, e shkëmbimi bëhet ari me arin, argjend me argjend;

2. Kur malli i mirë (24 karatë) shkëmbehet për mall më të dobët (18 karatë).

Këtu, dalilimet në peshë nuk kanë vlerë. Malli i mirë (24 karatë) shkëmbehet me të njëjtën peshë me mall të mirë (24 karatë), malli i dobët (18 karatë) shkëmbehet me të njëjtën peshë me mall të dobët (18 karatë). Por, nëse shkëmbehet ari me argjend ose argjendi me ari, këtu nuk ka kamatë.

3. Kur prodhimet janë punuar me përzierjen e arit dhe argjendit.

Nëse në monedhë nuk dihet përqindja e arit, ajo nuk duhet përdorur, pos nëse është monedhë në qarkullim. Do ta konsiderojmë si lehtësim i lejuar përdorimin e saj, në rast se nuk barazohet me vlerën e lirës prej ari. Njëjtë është edhe me monedhat e argjendit ku gjendet edhe një përqindje e bakrit. Nëse nuk është monedhë në qarkullim në atë krahinë, nuk është mirë të përdoret, sepse konsiderohet si monedhë nga argjendi, e sasia e argjendit nuk është e ditur. Nëse është pra monedhë qarkulluese në atë krahinë, përdorimin e saj gjatë

tregtisë dhe për nevoja të përgjithshme do ta konsiderojmë si lehtësim të lejuar, me atë që asnjëherë nuk vlerësohet njëjtë si monedha nga argjendi i pastër.

Njëjtë është me të gjitha stolitë e punuara me kombinimin e arit dhe argjendit. Nuk i lejohet ta blejë, as si ari e as si argjend, e mund ta blejë si mall tjetër. Megjithatë, nëse masa e arit në atë kombinim është e njohur, sepse prarimi i është bërë ashtu që ari mund të nxjerret me shkrirje, lejohet të blehet, me sasinë e caktuar të argjendit, ose diçka tjetër që nuk është argjend.

Sarrafit nuk i lejohet që me ar të tregtojë qaforen në të cilën ka kombinim të margaritarëve me ar, por ta blejë me argjend, nga dora në dorë, nëse në vet qafore nuk ka argjend. Nuk lejohet që me ar të blehet pëlhurë e qëndisur me ar, edhe nëse ari mund të nxjerret me shkrirje. Lejohet blerja me argjend, ose diçka tjetër.

Kur bëhet fjalë për ata që merren me shitblerjen e ushqimit, ata obligohen që shkëmbimin ta bëjnë në vendin e ngjarjes, pa marrë parasysh se a ka qenë malli që tregtohet i llojit të njëjtë apo i ndryshëm. Nëse bëhet fjalë për llojin e njëjtë, janë të obliguar që, gjatë shkëmbimit, të kenë kujdes në barazimin e vlerës.



Ekziston tradita që kasapit t'i jepet një dele, e me këtë të merret mish, menjëherë ose më vonë, e që nuk është e lejuar.

Tradita që bukëpjekësit t'i jepet grurë, e me këtë të merr bukë, menjëherë ose më vonë, njëjtë nuk lejohet.

Njëjtë është rasti kur tregtarit të vajit t'i jepet farë, susam ose ullinj, e me këtë të merr vaj, ose bulmetores t'i jepet qumësht, e me këtë të merr djathë, kajmak, mazë ose ndonjë produkt tjetër qumështi.

Një ushqim shkëmbehet me lloj tjetër të ushqimit kurse lloji i njëjtë edhe me para edhe me vlerë të njëjtë. Ngjashëm kësaj, cilindo ushqim që është përpunuar ose është nxjerrë diçka prej saj, nuk lejohet shitblerja as për vlerë të njëjtë, as me sasi shtesë. Për shembull: me grurë - përpunimin e grurit si miell, bukë ose krunde, me rrush - përpunimet e rrushit si reçel dhe uthull ose me hurme - prodhimet prej hurmes, si reçel a uthull, ose edhe me qumësht - përpunimet e qumështit si mazë, hirrë ose djathë.

Pa u vendos ushqimi në hambar dhe pa arritë në vend të tregtimit, as vlera e njëjtë nuk luan rol. Për shembull nuk bëhet shkëmbimi i hurmes së papjekur me hurme të papjekur ose rrushit të gjelbër me rrush të gjelbër; as për sasi të njëjtë, as me sasi të shtuar.

Këto informata mjaftojnë për të njohur shitblerjen. Ato janë paralajmërim për tregtarin që, kur të hetojë arsye për parregullsi, të kërkojë zgjidhje të bazuar në rregulla, për atë që do të mund të ishte e dyshimtë ose e paqartë. Nëse për këtë nuk ka njohuri, ai as nuk do të mendojë për çështjet e dyshimta, e kështu, pa e hetuar ky, kamata e harami do t'i futen në punë.

Marrëveshja e tretë  
PAGESA E PARAKOHSHME DHE DORËZIMI I  
MËVONSHËM I MALLIT

Këtu duhet pasur kujdes për dhjetë kushte:

1. Shuma e vlerës së mallit duhet të jetë saktë e ditur, që në rast të pamundësisë së dorëzimit të mallit, të kthehet shuma e saktë. Nëse me grusht kapen disa dërhëmë e me to paguhet një thes miell, një marrëveshje e tillë nuk do të ishte valide;

2. Shuma e vlerës së mallit duhet të dorëzohet në vendin ku është bërë marrëveshja, para se të ndahen. Nëse ndahen para dorëzimit të shumës, marrëveshja anulohet;

3. Duhet të jetë i mundur përshkrimi i cilësisë së mallit që do të blehet, si: fara, kafshë, minerale, pambuk, lesh, mëndafsh, qumësht, mish, parfum, e tjera. Nuk mund të kërkoen përzierje, as ajo që

përbëhet nga pjesë të llojeve të ndryshme, si harqet e përpunuara dhe shigjetat e stilizuara, pastaj mestet dhe sandalet e punuara me pjesë nga lëkurat e ndryshme. Lejohet pagesa më herët për bukë, kurse sasia e kripës dhe pjekja më shumë ose më pak nuk është e rëndësishme;

4. Të kërkohet përshkrim më i detajuar i mallit që blehet, e përshkrimi të jetë i tillë që arsyeton vlerën e caktuar për atë mall specifik, që të evitohen mashtrimet e mundshme. Një përshkrim i tillë duhet të jetë sikur të jetë parë malli gjatë shitblerjes;

5. Afati i dorëzimit të mallit të kërkuar të përcaktohet saktë. Dorëzimi i mëvonshëm i mallit nuk duhet të lidhet me të korrat apo me pjekjen e frutave, por të lidhet me muaj e ditë të caktuar, sepse pjekja e drithit ose frutave nganjëherë ndodhë para kohe, e nganjëherë vonohet;

6. Koha e dorëzimit të mallit të kërkuar të caktohet kur edhe është koha e mallit; nuk duhet caktuar afatin e dorëzimit të rrushit në kohën kur rrushi as nuk është pjekur, e njëjtë edhe me pemët tjera. Nëse është koha e atij fruti, por paraqitet pamundësia e dorëzimit, për shkak se personi i caktuar është sëmurë a për ndonjë arsye tjetër, atëherë blerësi mund të zgjatë afatin e dorëzimit, ose të kërkojë t'i kthehet shuma që e ka dhënë;

7. Të precizohet vendi i dorëzimit të mallit, e kjo për të evituar çfarëdo keqkuptimi;

8. Malli i kërkuar të mos ndërlihet me një lokacion të caktuar, e të thuhet: *“dua grurë nga kjo arë”*, apo *“i dua frutat nga kjo bahçe”*. Në atë rast, furnizuesi nuk e ka obligim të respektojë kërkesën. Por nuk ka dëm nëse kërkohet malli nga një qytet ose krahinë e caktuar;

9. Të mos paguhet para kohe për mall të shtrenjtë e që vështirë sigurohet; për shembull, të kërkohet një margaritar detajisht i përshkruar i cili shumë vështirë gjindet, ose kërkohet një robëreshë shumë e bukur, e edhe me fëmijë, dhe kërkesa tjera të ngjashme, për mall i cili vështirë gjindet;

10. Nëse paguhet për ushqim, të paguhet me ushqim, ose dukati të paguhet me dukatë. Këtë e shpjeguem te marrëveshja për kamatën.

## Marrëveshja e katërt

### QIRAJA

Marrëveshja për qiranë i ka dy kushte: shuma e qirasë dhe fitimi.

Sa i përket marrëveshjes mes palëve dhe përmbajtjes së marrëveshjes, vlenë ajo që kemi përmendur te shitblerja.

Shuma e qirasë trajtohet si paraja në shitblerje. Nëse bëhet fjalë për para në dorë, është e domosdoshme që shuma të bëhet e njohur dhe e definuar siç e përmendëm te shitblerja, e nëse është veresie, është e domosdoshme të dihet shuma e qirasë dhe të specifikohen kushtet.

**Kushti i parë** është largimi nga disa gjëra që janë bërë si traditë mes njerëzve në marrëveshje për qira.

- Marrëveshja për marrje me qira të shtëpisë në shkëmbim për meremetimin e saj, nuk është e pranueshme, sepse nuk dihet se sa para do të shpenzohen për meremetim. Edhe po të caktohej shuma, nuk është e pranueshme të kushtëzohet kjo shumë në investimet e duhura për meremetim, sepse çmimi i punës mbetet i panjohur.

- Nuk lejohet as që të kushtëzohet punëtori qiraxhi që rrjepë kafshë, se do të paguhet me lëkurë të kafshës, e as punëtori qiraxhi që bartë cofëtinat e

kafshëve, të kushtëzohet se do të paguhet me lëkurat e atyre kafshëve. Njëjtë me qiranë e mullixhiut të paguar me krunde ose miell, që nuk konsiderohet e lejuar. Të gjitha këto janë produkte prej punës së punëtorit. Me këto nuk mund të merret punëtor me qira dhe pagesa duhet të përcaktohet më herët.

- Si kushtëzim i papranueshëm llogaritet edhe përcaktimi i qirasë për përdorimin e shtëpisë, dyqanit, hanit e hamamit, dhe ndërtesat me pagesë mujore, pa përcaktimin e kohëzgjatjes së përdorimit. Për shembull, qiradhënësi e cakton se qiraja mujore do të jetë kaq e kaq, por nuk e cakton afatin e dhënies së hapësirës me qira. E meqenëse afati nuk është i njohur, as marrëveshja nuk është e lejuar.

**Kushti i dytë** është fitimi nga qiraja (e punëtorit). Pra, të sigurojë fitim nga personi që do ta paguaj për të kryer një punë. Këtu fitim është vetëm puna. Kjo duhet të jetë punë e lejuar dhe e njohur. Natyrisht, personi që do të punojë duhet të lodhet në këtë punë. Nëse mund të gjej zëvendës për një punë të lodhshme, pagesa për një angazhim të tillë është e lejuar.

Të gjitha rregullat për këtë temë mund të përmbledhen me kaq, e as ne nuk do ta zgjasim, sepse për këtë kemi folur në pjesët e fikhut.

Të tregojmë vetëm disa çështje të përgjithshme e të domosdoshme, në të cilat ai që merr punëtor qiraxhi duhet mirë të ketë kujdes.

E këto janë pesë:

1. Puna duhet të jetë e vlefshme; pra - punëtori duhet të lodhet në atë punë.

Nëse merr me qira ndonjë artikull ushqimor për të zbukuruar vitrinën e dyqanit, ose dru zbukurues për të varrë rrobat, e të ngjashme, këto nuk lejohen, sepse në to nuk ka ndonjë vlerë. Kjo është sikur një farë gruri, e ajo sasi as nuk lejohet të tregtohet. Sikur kur shikohesh në pasqyrën e tjetrit, pi ujë në bunar të huaj, pushon nën hijen e murit të huaj, merr prush nga zjarr i huaj.

Prandaj nuk i jepen para tellallit që me fjalë të bukura t'ua shesë mallin e huaj. Më në fund, ai do të flasë dy-tri fjalë. Pagesën që e merr në shkëmbim për fjalët e tij që lavdërojnë mallin (e huaj), e ka haram, sepse në të folurit e tij nuk ka lodhje. Ju lejohet pagesë nëse lodhen duke hyrë e dalë nga dyqani, ose duke folur shumë gjatë kryerjes së punëve, e kanë të drejtë në pagesë vetëm aq sa paguhet edhe të tjerët për punë të njëjtë, kurse pagesa sipas qejfit, nuk është e lejuar.

2. Me qira nuk mund të merret vetëm një pjesë prej një tërësie, dhe ajo pjesë të përdoret për fitim.

Për shembull nuk mund të lejohet marrja me qira vetëm e rrushit, pa vreshtë, ose të marrë me qira vetëm leshin, e jo edhe delen, ose vetëm qumështin, pa lopë, ose vetëm frutat, pa pemishte. Këto janë gjëra ende të panjohura, që të mund jepen me qira, dhe për këtë arsye nuk lejohet.

Megjithatë, lejohet të merret me qira gjidhënësja për fëmijën, sepse është e pamundur të ndahet qumështi prej saj. Njëjtë mund të trajtohet edhe ngjyra e shkrimit në letër ose fija e rrobaqepësit - për këto ka tolerancë.

3. Punëtori duhet të jetë i fuqishëm fizikisht dhe sipas shariatit, që t'i ofrohet puna me pagesë.

Nuk është e drejtë të merret me qira personi fizikisht i dobët për të kryer punë që nuk do të mund t'i kryejë, ose memeci për të dhënë mësim, e të ngjashme.

Njëjtë është edhe me gjërat e ndaluara me shariat. Sheriati nuk lejon kryerjen e punëve si: nxjerrjen e dhëmbit të shëndoshë, amputimin e organit që sheriati nuk e lejon, të merret punëtore qiraxhi gruaja me të përmuajshme për të pastruar xhaminë, ose marrja me qira e mësuesit për të mësuar sehire, magji ose ndonjë zanat të shthurur,



ose të merret me qira gruaja e dikujt për gjidhënie fëmijës pa lejen e burrit të saj, ose të paguhet piktori për të pikturuar kafshë, ose argjendari për të bërë enë nga ari e argjendi.

Të gjitha këto janë të padrejta.

4. Puna që kërkohet me marrëveshje të jetë punë ku personi nuk mund të përfaqësojë tjetrin.

Kështu, nuk lejohet me pagesë të përfaqësohet tjetri në luftë (xihad), sepse lufta është farz për vet personin, e nuk mund ta përfaqësojë dikush tjetër e as për ndonjë ibadet, sepse edhe ibadetet trupore janë farze për vet personin, e nuk mund të ketë përfaqësim, e as që me pagesë të dikujt do të mund të largohet obligimi.

Por, lejohet të merret përfaqësues dhe pagesa është hallall për haxh (*bedel*)<sup>32</sup>, për të larë xhenazen, për hapje të varrit, varrimin e të vdekurit dhe bartjen e xhenazes. Njëjtë vlenë për udhëheqjen e xhematit në namazin e taravisë, për këndim të ezanit, ose për mësim. Rreth pagesës për mësimin e Kur'anit ka mospajtim mes dijetarëve, por lejohet pagesa me qëllim që personit të caktuar t'i mësohet ndonjë çështje e caktuar lidhur me Kur'anin, ose një sure e caktuar.

---

<sup>32</sup> Sipas Hanefisë, për haxh bedeli nuk paguhet por vetëm i mbulohen shpenzimet.

5. Puna dhe fitimi duhet të jenë plotësisht të njohura.

Nëse bëhet fjalë për rrobaqepësin, duhet të dijë çfarë rroba dhe sa do të qepë.

Nëse bëhet fjalë për mësuesin, ai duhet ta dijë se cilën sure do t'ua mësojë dhe sa e gjatë është sureja.

Nëse bëhet fjalë për kafshën e cila duhet të bartë ndonjë ngarkesë, atëherë duhet të dihet sasia e ngarkesës dhe distanca e bartjes.

Pra, nuk lejohet të anashkalohet çkado qoftë që mund të shkaktojë debat e keqkuptime.

Të flitet për të gjitha, do të zgjatej shumë. Ne i përmendëm vetëm disa, që të njihen rregullat bazike. Shpjegimi i plotë i tyre është i gjatë, e këto që i përmendëm qëllim kanë njohjen vetëm e rregullave themelore dhe të çështjeve problematike, si dhe kërkimin e zgjidhjes.

Njohja e të gjitha detajeve në këto çështje është detyrë e myftiut, e jo obligim për njerëzit e zakonshëm.

## Marrëveshja e pestë

### KAPITALI DHE PUNA

Te kjo marrëveshje tregtia është e përbashkët mes dy personave, njëri me kapital e tjetri me punë. Në këtë çështje ka tri kushte që duhet të respektohen:

Kushti i parë është kapitali.

Kusht është të jenë para të gatshme, të jetë shumë e caktuar saktë dhe t'i dorëzohet personit të angazhuar me punë.

Nuk duhet të jetë pasuri e luajtshme apo e paluajtshme sepse tregtia me to nuk është e shpeshtë. Nuk lejohet as një qese dërhemë si kapital, për shkak që nuk dihet shuma e saktë. E kur nuk dihet kapitali i saktë as fitimi nuk mund të përcaktohet saktë.

Nuk mund të lejohet as që pronari i kapitalit të kushtëzojë që fjala e tij të jetë vendimtare, sepse do të ngushtojë hapësira për tregti.

Kushti i dytë është fitimi.

Edhe fitimi duhet të përcaktohet me përqindje, si me një të tretën, me gjysmën, ose me ndonjë tjetër pjesë. Nëse pronari i kapitalit thotë: “nga

*fitimi, ty të takojnë njëqind dërhëmë, mua pjesa tjetër”, një kusht i tillë nuk mund të lejohet, sepse mund të ndodhë që fitimi të mos arrijë as atë njëqindësh.*

Prandaj nuk lejohet përcaktimi i shumës së saktë të fitimit, por ajo definohet me përqindje.

Kushti i tretë është puna të cilën duhet ta kryejë i angazhuari.

Pronari i kapitalit nuk duhet ta kufizojë atë në tregti ose ta detyrojë me diçka tjetër. Nëse pronari i kapitalit kushtëzon që punëtori me kapitalin e tij të blejë lopë, por që do të presin të pllenohet lopa dhe të përfitojnë prej viçit, ose të blejë grurë, që prej tij të prodhojë bukë e tek fitimin nga shitja e bukës ta ndajnë mes vete, kjo nuk është e drejtë. Sepse marrëveshja për ortakëri është tregti dhe punë rreth tregtisë si matje, peshim e vlerësim, por vetëm kaq, kurse pjekja e bukës dhe kujdesi për kopenë e lopëve janë zanate tjera.

Nëse pronari i kapitalit kushtëzon të angazhuarin me punë për të blerë mall vetëm nga një person i caktuar, ose vetëm stof të një ngjyre, ose çfarëdo kufizimi tjetër, marrëveshja ndërprehet. Pas ndërprerjes së marrëveshjes mes vete në mënyrë të prerë, i angazhuari bëhet përfaqësues dhe menaxhon me mallin si përfaqësues.

Pronari i kapitalit mund të anulojë marrëveshjen kur të dojë. Nëse marrëveshja anulohet në situatën kur i gjithë malli është në para të gatshme, atëherë nuk ka problem; edhe kapitali edhe fitimi janë të njohura. Pasi që e merr kapitalin fillestar, fitimi ndahet me lehtësi.

Nëse është vetëm malli e para nuk ka, dhe nuk ka pasur fitim, malli i kthehet pronarit të kapitalit dhe prapë nuk ka problem, kurse i angazhuari nuk do të ishte i obliguar ta kthejë atë mall në para të gatshme, sepse marrëveshja është anuluar.

Nëse i angazhuari do të thoshte: *“E kisha shitur këtë”*, e pronari refuzon, do të veprohet sipas qëndrimit të pronarit, por nëse i angazhuari tashmë ka gjetur blerësin që siguron fitim, atëherë vepron sipas qëndrimit të vet.

Kur lajmërohet rasti për fitim, i angazhuari është i obliguar të shesë shumën e kapitalit bazë për kapital të llojit të njëjtë, që të mund të ndahet shtesa si fitim, ku ata kanë hise. Në atë rast, nuk obligohen që të shesin edhe shtesën mbi kapital.

Nëse kapitali qëndron mbi një vit, detyrohen të llogarisin vlerën e pasurisë, për shkak të zeqatit. E nëse ka edhe fitim, më e logjikshmja do të ishte që zeqati për pjesën që i takon të angazhuarit ta japë vet ai, pasi që ai është pronari i qartë i asaj pjese të fitimit.

I angazhuari nuk mund të shkojë në një vend tjetër për të blerë mall pa lejen e pronarit të kapitalit.<sup>33</sup> Nëse shkon (pa leje), blerja është e vlefshme, por vet i paguan harxhimet e udhëtimit. E nëse shkon me lejen e pronarit të kapitalit, atëherë harxhimet e udhëtimit, transportit të mallit dhe të ruajtjes së mallit i paguan pronari i kapitalit.

Gjithashtu, harxhimet e matjes dhe transportet që nuk janë të zakonshme për tregtarin do të shkojnë në llogari të pronarit të kapitalit. Për mbështjellje të rrobave dhe punë tjera të lehta, harxhimet i llogariten punëtorit.

Është obligim i punëtorit që të bartë harxhimet e ushqimit dhe banimit për vete në vendin e tij. Qiranë e dyqanit nuk e paguan. Nëse obligohet të shkojë jashtë për tregti, të gjitha harxhimet shkojnë në llogari të pronarit të kapitalit. Kur kthehet nga rruga, i angazhuari obligohet të kthejë gjërat e nevojshme për rrugë si ibriku, sofrabesi e të ngjashme.

---

<sup>33</sup> Sipas Imam Hanefisë, në kohëra të sigurta mund të shkojë.

## Marrëveshja e gjashtë ORTAKËRIA

Janë katër lloj ortakërish. Tri janë të padrejta:

### 1. Ortakëria e përbashkët.

Ky lloj ortakërie është kur dy persona pajtohen të bashkojnë mallërat që posedojnë, fitimin dhe humbjen, borxhet, shpenzimet dhe pasurinë që e trashëgojnë. Një ortakëri e tillë nuk është e drejtë.

### 2. Ortakëri në bashkimin e forcës.

Ky lloj ortakërie është kur kushtëzohet ndarja e fitimit të punës fizike me trup si hamall, tellall dhe ngjashëm. As kjo ortakëri nuk është e drejtë.

### 3. Ortakëri e bazuar në reputacion.

Kjo është kur, njërin nga ta njerëzit e nderojnë dhe i pranohet fjala, prandaj ky person me ndikim merr detyrën të sjellë mall nga njerëzit, e tjetri e sjell punën. As ky lloj i ortakërisë nuk është i drejtë; dhe

### 4. Ortakëria e besimit.

Ky lloj i ortakërisë është kur dy palët bashkojnë kapitalin dhe njëri-tjetrit i japin autorizimin e menaxhimit, pastaj edhe fitimin edhe humbjen e ndajnë sipas vlerës së kapitalit të secilës palë.

Vetëm ky lloj i ortakërisë është i drejtë. Ky rregull nuk lejohet të ndyshohet me ndonjë kusht të caktuar, ose me tërheqjen e njërit prej tyre, ashtu që këtij tjetrit i pamundësohet të posedojë pronën e vet, ose me ndarje të caktuar, që do të sillte deri te copëtimi i njëres pasuri nga tjetra.

Është e drejtë të lejohet ortakëri për blerje të mallit, me atë që nuk kushtëzohet me para të gatshme, ndryshe nga tregtia me kapital të huaj me hise në fitim.

Kaq dituri nga fikhu duhet të posedojë secili që në ndonjë mënyrë bën tregti, sepse pa këtë, mund të futet në fushën e haramit, e që për këtë as të mos jetë i vetëdijshëm.

Nuk ka dallim as sa i përket tregtisë së kasapit, bukëpjekësit apo pemëshitësit; edhe ata duhet të njohin këto rregulla.

Këtu, lëshimet bëhen në tri mënyra:

- me mospërfilljen e kushtit të shitblerjes,
- me mospërfilljen e kushtit të pagesës së parakohshme, ose
- me kufizim vetëm në pranim-dorëzim, pa deklarime formale.



Rregullat e zakonshme, te këto kategori të zanatlijnëve bëhen duke shënuar nevojat e përditshme, pastaj barazimi në kohë të caktuar, e më pas me vlerësim, përshtatshëm asaj se si arrihet marrëveshja që i kënaq të dy palët.

Këtë e shohim si diçka që definohet si e lejuar, kur është nevoja. Kjo nënkupton që ata e dorëzojnë mallin, që është e lejuar të pranohet malli me pagesë të mëvonshme, dhe që të ngrënit e mallit të tillë është hallall.

Megjithatë, bashkë me këtë nevojitet edhe garancioni se malli do të harxhohet, dhe se obligohet që pagesa të jetë për vlerën e mallit në ditën e harxhimit të tij.

Garancioni duhet në vete të përfshijë këto vlera. E nëse ata janë pajtuar për një çmim, atëherë nga ta duhet kërkuar lirim nga garancioni për çmimin në ditën e harxhimit, që kjo të mos mbetet si obligim, në rast se vjen deri te dallimi në çmim.

Në këtë hapësirë është e domosdoshme të shkohet me modesti në kërkesa dhe me disponim.

Obligimi i vlerësimit të çmimeve para secilës nevojë, për çdo ditë, e në secilin moment, është një obligim mjaft i rëndë. Njëjtë është me obligimin për

zbatimin krahas kësaj edhe të principeve të ofertës dhe pranimi, si edhe me vlerësimin e vazhdueshëm të gjërave që kanë pak vlerë. Sa më me vlerë të jetë malli, i çfarëdo lloji, më lehtë është të vlerësohet, kurse udhëzimi vjen nga Allahu.

## Kapitulli i tretë

### **LARGIMI NGA PADREJTËSIA DHE PËRSHTATJA DREJTËSISË NË TREGTI**

Dije se: për korrektësinë e mënyrës se si zhvillohet marrëdhënia tregtare midis dy njerëzve, fetvanë e jep muftiu.

Tregtia mund të futet edhe në fusha për shkak të të cilave, palët në tregti mund t'i ekspozohen zemërimit të Allahut Teala. Por, gjithçka që është e ndaluar nuk nënkupton edhe prishjen e marrëveshjes.

Kjo ndahet në dy pjesë: në dëmin që është i përgjithshëm dhe në dëmin e veçantë – që prekë njërën palë të përfshirë në marrëveshje.

#### **Pjesa e parë DËMI I PËRGJITHSHËM**

Edhe kjo është disa llojesh:

Lloji i parë është *spekulimi* (tregu i zi).

Ky është rasti kur shitësi e deponon mallin ushqimor, që të presë rritjen e çmimit. Kjo është padrejtësi e përgjithshme.

Ai që vepron kështu, sipas shariatit është njeri i keq. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Kush e mbyll mallin e ushqimit për katërdhjetë ditë, edhe nëse e ndanë me pas gjithë atë mall si sadaka, nuk do t’i jetë pastrim për spekulimin e bërë.”<sup>34</sup>**

Abdullah b. Omeri r.a., transmeton nga Resulallahu s.a.v.s.:

**“Kush e mbyll mallin për ushqim katërdhjetë ditë, dhe nuk e nxjerrë në shitje, nuk ka asgjë me Allahun, e as Allahu nuk ka asgjë me të.”<sup>35</sup>**

Thonë se spekulatori është:

**“...sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit...”**

5-Maide: 32

Transmetohet se Alia r.a, ka thënë.:

**“Atij që e mbyll mallin e ushqimit për katërdhjetë ditë (për ta shitur me çmim më të lartë), i ngurtësohet zemra.”**

Bile ka shënime që Alia r.a., i ka dhënë flakën një malli të ushqimit që dikush e kishte mbyllur për spekulim.

---

<sup>34</sup> Ebu Mansur Dejlemiu në *‘Musned-i Firdevs’*, transmeton hadithin nga Alia r.a., dhe Hatib në *‘Tarih’* nga Enesi r.a.

<sup>35</sup> Ahmedi dhe Hakimi nga Ibn Omeri r.a., me sened të mirë.

E për vlerën e atyre që ruhen nga spekulimet me ushqim, shpjegon ky hadith:

**“Kush sjellë ushqim (nga jashtë) dhe e shet atë me çmimin e tregut të ditës, është sikur t’i kishte dhënë të gjitha sadaka.”**

e në versionin tjetër:

**...sikur të kishte liruar një skllav.<sup>36</sup>**

Thuhet që edhe spekulimi (shitja me çmime më të larta se sa është vlera në treg) është një lloj i zullumit të përmendur në ajet:

**...e kush synon të bëjë në të (Mesxhidil-haram) ndonjë zullum, Ne do t’i japim të shijojë dënimin e dhembshëm. 22-Haxh: 25,**

dhe që bie nën kërcënimin e përmendur.

Njëri nga gjeneratat e para kishte shkuar në qytetin Vasis, dhe kishte ngarkuar një anije me drithë për në qytetin e Basras. Përfaqësuesit të tij i shkroi:

*- Këtë drithë shite menjëherë atë ditë kur ushqimi arrin në Basra, e mos e shtyej për ditën tjetër.*

Tregtarët i thanë përfaqësuesit:

*- Tani ka me bollëk, shtyeje shitjen për një javë, e do të fitosh shumëfishin e kësaj.*

---

<sup>36</sup> Shënon Ibn Merduje në ‘Tefsir’, nga Ibn Mesud r.a..

Ashtu bëri, dhe fitoi shumëfishin. E njoftoi pronarin e mallit përmes letrës, e ky ia ktheu:

*- Fitimi i ditës së parë do të na ishte i mjaftueshëm, dhe në përputhje me besimin tonë, e ti veprova të kundërtën. Ne nuk duam të kemi më shumë fitim duke humbur nga feja jonë. Na ke shkaktuar të keqe të madhe. Kur të të arrijë kjo letër e imja, gjithë atë pasuri ndaje si sadaka për të varfërit e Basras. Inshallah kjo më mjafton të më shlirojë nga gjynahu i spekulimit (të mallit), e të vij në gjendje të mos kem as shpërblim e as dënim.*

Dije se, urdhëri që ndalon spekulimin është i prerë. Në këtë çështje duhet kujdes për *llojin* e ushqimit dhe *kohën* e spekulimit.

### **Lloji i ushqimit**

Spekulimi është ndaluar për çdo lloj ushqimi, por jo edhe për atë që futet në organizëm e nuk është ushqim, siç janë ilaçet, serumet, shafrani e të ngjashme.

Pikëvështrimet dallojnë për shtesat në ushqim, siç janë mishi e pemët, ose për atë që në situata të caktuara mund të zëvendësojë ushqimin, por që nuk mund të përdoret gjatë si ushqim. Një grup i dijetarëve përfaqësojnë mendimin se spekulimi

përfshinë edhe ynydrën, mjaltin, djathin, vajin e ullirit, susamin dhe artikuj të ngjashëm.

### **Koha e spekulimit**

Edhe për kohën e spekulimit ka mospajtime. Këtë më së miri e tregon rasti i përmendur nga Basra.

Spekulimi mund edhe të lidhet për një kohë konkrete, siç është koha e mungesës së ushqimit të domosdoshëm për njerëzit, kur shtyerja e shitjes së tij mund t'i dëmtojë ata.

Por nëse është kohë kur ushqim ka mjaft e njerëzit nuk kanë nevojë ta sigurojnë atë në sasi më të mëdha, dhe nuk duan ta blejnë pos nëse është me çmim më të ulët, pronari i mallit mund ta deponojë një pjesë të mallit për këtë arsye, e jo që po pret mungesë të atij malli për ta shitur me çmim më të lartë, dhe kjo nuk i shkakton dëm askujt.

E në kohë të mungesës, nëse deponon mallin si mjalta, vaji, yndyra, djathi e artikuj të ngjashëm, kjo është spekulim nëse i dëmton njerëzit.

Do të thotë: a është spekulimi haram apo jo, lidhet me dëmin që ai spekulim shkakton. Edhe po të mos shkaktonte kurrfarë dëmi, fsheja e ushqimit mbetet veprim i mospëlqyer, sepse llogaritet si fillim i dëmit pasi që kjo bëhet sepse për ngritjen e çmimit, nëse në treg nuk gjendet mjaftueshëm malli i tillë, dhe kjo është dëm për popullin.

Pritja e filimit të dëmit është po aq i rrezikshmëm sa edhe vet dëmi, pos që shkalla e dëmit është më e ulët. Varësisht shkallës së dëmit, ndryshon shkalla e haramit.

Shkurtimisht, tregtia me produkte ushqimore nuk është e këshillueshme, sepse në tregti të ushqimit ka përfitim nga nevojat e domosdoshme për njerëzit. Prandaj është më e përshtatshme të kërkohet fitim në mallëra tjera, e jo në nevojat e domosdoshme për të gjithë.

Njëri nga taibintët e këshilloi një person:

*“Fëmijës tënd mos i lejo dy tregti: shitjen e ushqimit, sepse do t’ju dëshirojë njerëzve mungesë të ushqimit, dhe shitjen e qefinit, sepse do t’ju dëshirojë njerëzve vdekjen, sepse këto do t’i sigurojnë tregti të bollshme.*

*E mos i lejo as dy zanate: zanatin e kasapit, sepse e ngurtëson zemrën, dhe atë të argjendarit, sepse ai mundohet ta zbukurojë dynjanë.”*

Lloji i dytë i dëmit të përgjithshëm, është lëshimi në qarkullim i parasë false.

Kjo është zullum, sepse do ta përdorë edhe ai që bën shitblerje, deri sa të mos e dijë që janë të rrejshme, e kur ta kuptojë, mund t’ia jap tjetrit, e ky tjetër kujt, e me radhë. Ajo do të kalojë nga dora në dorë, e në këtë mënyrë shtohet dëmi dhe



padrejtësia. Gjynahet e të gjithëve do të kthehen te ai i pari që e ka filluar, sepse ai ia ka hapur dyert kësaj të keqeje.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**Kush sjellë një praktikë të shëmtuar, e ashtu fillojnë të veprojnë të tjerët pas tij, do ta bartë barrën e gjynahut të vet, dhe barrën e gjynaheve të të gjithëve që kanë vepruar si ai, pa iu pakësuar atyre asgjë nga gjynahet.<sup>37</sup>**

Disa kanë thënë:

*“T’i jepet vetëm një dërhëm fals tjetrit është gjynah më i madh se sa të vidhen njëqind të vërtetë.”*

Vjedhja është një gjynah dhe me kaq përfundon, kurse ai që nxjerr në treg një dërhëm fals me të cilën do të shërbehen edhe të tjerët pas tij, për çka do ta zë barra e gjynaheve të njëqind, ndoshta edhe dyqind viteve pas vdekjes së tij, deri sa ai dërhëm i rrejshëm të mos zhduket. Do të jetë përgjegjës edhe për të gjitha dëmet që me këtë veprim të tij do t’i shkaktohen pasurisë së të tjerëve. Lum ai që me vdekje i vdesin edhe gjynahet, e mjerë ai që vdes e gjynahet të vazhdojnë edhe pas tij, për të cilat do të ndjejë vuajtje deri sa është në varr, e do të japë përgjegjësi, deri sa ato të vazhdojnë.

---

<sup>37</sup> Shënon Muslimi nga Xherir b. Abdullahu.

Allahu Teala thotë:

**“...(Ne) shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e (punëve të) tyre...”** 36-Ja Sin: 12,

pra, i shënojmë veprat që kanë bërë deri në vdekje, si edhe pasojat e mira dhe të këqija pas vdekjes.

Allahu Teala thotë:

**“Atë ditë njeriu do të njihet me atë që çoi para dhe me atë që la prapa.”** 13-Kijame: 13,

e atë që la prapa janë gjurmët e veprimeve të tij të shëmtuara, sipas së cilëve punojnë të tjerët pas tij.

Për paratë fals, njeriu duhet të dijë pesë gjëra:

1. Nëse i vjen në dorë ndonjë para e rrejshme, le ta hedhë në bunar, që të mos përcjellet tutje. Assesi të mos e përdorë për tregti të mëtutjeshme. I lejohet edhe ta dëmtojë, në atë masë që të mos mund të përdoret më si para.

2. Tregtari duhet ta njohë mirë paranë fals, dhe kjo nuk është vetëm për ta shpëtuar veten, por edhe që myslimanit të mos ia japë paranë e rrejshme, qoftë edhe pa qëllim, prandaj bën gjynah me braktisje të kësaj njohurie.

Për secilin veprim lidhet një dituri e veçantë; ajo e plotëson pastërtinë e punëve mes myslimanëve, prandaj duhet njohur. Me këtë qëllim gjeneratat e para mësonin shenjat e njohjes së parasë së vërtetë; jo për dynjallëkun, por për ta ruajtur fenë e vet.

3. Edhe nëse një person jep para të rrejtshme dhe ai që i pranon e di që janë të rrejtshme, personi që i ka dhënë nuk mund të shpëtojë nga përgjegjësia, sepse ai që i ka marrë e ka për qëllim që tutje t'ua japë të tjerëve, duke mos u treguar që janë të rrejtshme. Po të mos kishte vendosur tashmë kështu, as nuk i kishte marrë.

Prandaj personi që jep para të rrejtshme, nuk mashtron vetëm atë që pranon, por që të dy janë bashkë edhe në gjyhahet e tjera që lidhen me dëmin e shkaktuar nga ata që vazhdojnë ta përdorin atë para të rrejtshme.

4. Le t'i marrë paratë e rrejtshme, që të veprojnë sipas fjalëve të Resulallahut s.a.v.s.:

**“Allahu Teala lëshon rahmet mbi robin që lehtë shet e lehtë blenë, që lehtë paguan (borxhin) dhe lehtë paguhet (tregon lehtësi kur merr borxhin).”<sup>38</sup>**

---

<sup>38</sup> Shënon Buhariu nga Xhabiri r.a..

Ai do të mbulohet me bereqetin e kësaj duaje, nëse vendos ta zhdukë paranë e rrejshme.

Por, nëse vendos që edhe më tutje ta përdorë, kjo është ligësi në të cilën e detyron shejtani, duke ia shfaqur këtë si të mirë, e i tilli assesi nuk merr pjesë në bereqetin e kësaj duaje.

5. Që me para të rrejshme të nëkuptohej paraja që në vete nuk përmbanë fare argjend, por ka vetëm ngjyrë a shkëlqim të argjendit, ose nuk përmbanë ar, por ka ngjyrë a shkëlqim të arit.

Por, nëse bëhet fjalë për paranë që në vete përmban argjend ose ari, qoftë edhe të përzier me bakër, dhe është valutë zyrtare e asaj krahine, dijetarët nuk kanë qëndrim të përbashkët për përdorimin e saj.

Ne anojmë kah qëndrimi se lejohet përdorimi nëse është valutë zyrtare në atë krahinë, pa marrë parasysh a dihet sasia e argjendit ose arit në të apo jo.

Por nëse nuk është valutë zyrtare, atëherë nuk lejohet. Përjashtim bën rasti kur dihet sasia e argjendit në të, e nëse ka më pak se në monedhën zyrtare, personi detyrohet që t'i informojë ata me të cilët punon, dhe do të bëjë tregti vetëm me ata që nuk lejojnë të futet në qarkullim çfarëdo paraje fals.

T'i jepen para të tilla atij që këtë e sheh të lejuar, do të thotë t'i jepet mundësia për keqbërje. Kjo është baraz me shitjen e rrushit atij për të cilin dihet se nga ai rrush do të bëjë verë. Kjo është e ndaluar, sepse është një lloj ndihmese të keqes, dhe pjesëmarrje në të.

Të mbahet rruga e të vërtetës në këtë segment të tregtisë është më e vështirë se sa të bëhen ibadete nafile.

Prandaj dikush ka thënë:

*“Tregtari i ndershëm është më me vlerë te Allahu se sa personi që bën ibadete nafile.”*

Gjeneratat e para të myslimanëve i kanë dhënë shumë rëndësi kësaj, dhe në këtë çështje kanë vepruar jashtëzakonisht kujdesshëm.

Një luftëtar tregon:

*“Ia vendosa shalën kalit, që të luftoj kundër armikut, por kali nuk pat fuqi, e u ktheva. Tri herë kështu veprua. Në fund, edhe kali më iku, e kurrë nuk kishte vepruar ashtu. U ktheva i mërziur, kokën poshtë, e me zemër të thyer, sepse armiku shpëtoi, e edhe kali më iku. E mbështeta kokën në mbajtësin e tendës, kur vërejta se kali ishte kthyer, e m'u afrua.*

*Aty më mori gjumi, e në ëndërr pashë se si kali më thotë:*

*- Pashë Allahun, ti e pate nijet të luftosh armikun, bile tri herë provove, e mua më bleve sanë me dërhëmë të rrejshëm! Kështu kurrë nuk do të jesh fitues!'*

*U zgjova i tmerruar, shkova te tregtari i sanës dhe ia ndërrova dërhemin e rrejshëm me para të vërteta..."*

Ky është shembull për dëmin e përgjithshëm, e sipas kësaj mund të përmenden edhe shembuj tjerë.

## Pjesa e dytë

### DËMTIMI I MYSHTERISË

Secili veprim që mund t'i shkaktojë dëm personit me të cilin tregtari punon, është padrejtësi.

Drejtësia kërkon që myslimani në asnjë mënyrë të mos e dëmtojë vëllanë e vet mysliman. Princip i përgjithshëm është se ai me vëllanë do të veprojë vetëm ashtu si do të donte të veprohej edhe ndaj vet atij. Siç nuk të pëlqen kur ty të bëhët padrejtësi dhe zemra vështirë ta pranon, aso padrejtësie myslimani nuk guxon t'i bëjë tjetrit. Për të, paratë e veta dhe të huajat, duhet të jenë të njëjta. Dikush ka thënë:

*“Ai që vëllait të vet i shet diçka për një dërhëm, e po ta blente për vete të njëjtën nuk do të paguante më shumë se pesë danekë (qindarka e dërhemit), ai nuk është duke vepruar sipas principit që na është urdhëruar, dhe nuk po ia dëshiron vëllait atë që e do për vete.”*

Kjo është një përmbledhje, ndërsa shpjegimi i hollësishëm përfshihet në katër pika:

1. Të mos lavdërohet shumë vlera e mallit;
  2. Të mos i fshehen të metat që malli i ka;
  3. Të mos mashtrohet për sasinë dhe peshën;
- dhe
4. Të mos fshehet diçka lidhur me çmimin.

Pra, informata të cilat, po t'i dinte myshteriu, nuk do ta blente mallin.

### **Lavdërimi i tepruar i mallit**

Nëse lavdërohet malli me cilësi që nuk i ka, kjo është gënjeshtër.

E nëse myshteriu blen duke u mashtruar me fjalët e tij, shitësi pos që po gënjen, gjithashtu edhe po e dëmton myshteriu.

E nëse myshteriu nuk blen, mbetet si gënjeshtër dhe shpirtligësi, sepse gënjeshtër del në shesh. Në fakt, çdo lloj gënjeshtre është shpirtligësi.

E nëse duke e lavdëruar mallin përmend gjithçka që mund të thuhet, e që nuk kanë ndonjë rëndësi të posaçme - qofshin ato edhe të vërteta, kjo paraqet fjalë të panevojshme dhe del nga korniza e asaj që i kërkohet shitësit, sepse për secilën fjalë që e thotë, do t'i duhet të japë përgjegjësi pse e ka thënë.

Allahu Teala thotë:

**“...dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).**

50-Kaf: 18



Ai mund t'i tregojë myshterisë cilësitë e mallit që myshteriu nuk i di dhe cilësitë e përgjithshme të mallit. Për shembull tregon pa lavdërim dhe shkurt karakterin e skllavit ose skllaves që shitet, ose natyrën e kafshës.

Nuk është dëm të përmendet sa i vlefshëm është ai lloj i mallit, pa e tepruar, dhe me qëllim që vëllanë mysliman ta njoftojë me mallin dhe ta zgjojë te ai dëshirën për ta blerë, e kështu t'i sigurojë vetes mjete për jetesë.

Krahas kësaj, assesi nuk bën të bëjë bé, sepse po të gënjejë - bën bé të rrejshme, që është nga gjynahet e mëdha që çojnë në shkatërrim.

E nëse e thotë të vërtetën, dhe bën bé në Allah, është gabim sepse kjo botë nuk është mjaft e vlefshme e të lavdërohet me emrin e Allahut, pa kurrfarë nevoje.

Në një transmetim, thuhet:

**“Mjerë tregtarit që thotë ‘vallahî po’ e ‘vallahî jo’ e mjerë edhe zanatlia që thotë ‘nesër (vij e rregulloj)’ e ‘masnesër (vij e rregulloj)’.”<sup>39</sup>,**

---

<sup>39</sup> Ebu Mansur Dejlemi në *‘Musned-i Firdevs’*, përmend një hadith të ngjashëm, nga Enesi.

E në një transmetim tjetër:

**“Beja e rrejshme e shet mallin lehtë, por e shkatërron bereqetin e fitimit.”<sup>40</sup>**

Ebu Hurejre tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Në ditën e Kiametit, Allahu as nuk do t’i shikojë tre persona: të varfrin mendjemadh, atë që kur jep diçka -vazhdimisht e përmend, dhe atë që e shet mallin duke bërë bé.”<sup>41</sup>**

Pra, lavdërimi i tepërt i mallit, qoftë kjo edhe e vërtetë nuk është i pëlqyer sepse paraqet fjalë të panevojshme e pa kurfarë shtimi të riskut, prandaj është i kuptueshëm dënimi i rreptë për të bërit bé.

Junus b. Ubejde ishte tregtar i një lloj kumashi, dhe i erdh një myshteri. Punëtori i Junusit e solli kumashin, e duke e shpalosur, tha: *“O Allah, na e fal xhenetin”*. Junusi menjëherë e urdhëroi që kumashin ta kthejë në vend, dhe nuk e shiti. Frikësohej se mos kjo kuptohet sikur punëtori e lavdëroi mallin.

Eh, të tillët duhet që në dynjallëk të merren me tregti, duke mos e shitur imanin e vet dhe duke e ditur që më e rëndësishme është të sigurohet fitimi për ahiret, se sa për dynja.

---

<sup>40</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

<sup>41</sup> Muslimi nga Ebu Hurejre dhe Ebu Dherr, si edhe Buhariu.

## **Të mos fshehen të metat e mallit**

Duhet të tregohen të gjitha mangësitë e mallit që po shitet, si të dukshmet, ashtu edhe ato që nuk shihen, dhe të mos fshihet asgjë.

Ky është obligim. Nëse fsheh çkado qoftë, do të ishte i padrejtë dhe mashtrues, e mashtrimi është haram. Me këtë ai do të braktiste edhe këshillën për shitje, e këshillimi dhe tregimi i drejtë për të gjitha mangësitë e mallit është detyrë e tij. Bile, kur e tregon vetëm anën e bukur të rrobës, dhe e fshehë atë më pak të bukur, është mashtrues. Njëjtë kur mallin e vendosë në vend jo mjaft të ndriçuar, ose kur në vitrinë vendosë mestet dhe këpucët më të mira që i ka, e raste tjera të ngjashme.

Ja një dëshmi se mashtrimi është haram:

*Resulallahu s.a.v.s., po kalonte pranë një tregtari që shiste artikuj ushqimor. Resulallahut s.a.v.s., i pëlqyen, e futi dorën mes artikujve, por hetoi lagështi në fund, dhe pyeti:*

**- Çfarë është kjo?**

*- I ka lagur shiu!, u përgjigj tregtari, e Resulallahu s.a.v.s., i tha:*

**E përse nuk i ke vendosur në maje, që njerëzit t'i shohin! Ai që na mashtron, nuk është prej neve.<sup>42</sup>**

---

<sup>42</sup> Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

Obligimin për këshillim, duke treguar të gjitha mangësitë e mallit që po shitet e dëshmon edhe ky transmetim, kur Xheriri erdhi te Resulallahu s.a.v.s., dhe e pranoi Islamin. Kur Xheriri u nis për t’u larguar, Resulallahu s.a.v.s., e tërhoqi për xhybeje dhe i kërkoi që t’ua këshillojë tregtinë të gjithë myslimanëve. E kur Xheriri shiste, fillimisht i tregonte mangësitë e mallit, e pas kësaj blerësit i jepte zgjedhje:

*- Nëse do, merre, e nëse nuk do, lëre.”*

Njerëzit i thonin:

*- Nëse kështu vazhdon, nuk do të fitosh asgjë!”*, e ai u përgjigjej:

*- Ne ia kemi dhënë fjalën Resulallahut s.a.v.s., se do të këshillojmë të gjithë myslimanët dhe do të flasim të vërtetën. Fitova apo jo, nuk e ndryshoj fjalën”<sup>43</sup>*

Vaile b. Eska qëlloi pranë njërit, kur ai e shiti një deve për treqind derhemë. Vaile e pa një plagë në këmbë të deves dhe dëshiroi t’i tregojë blerësit, por për një moment harroi, dhe u përkujtua vetëm kur e pa blerësin që tashmë ishte nisur, me devenë e blerë. Vaile vrapoi pas tij dhe i tha:

*- O ti, a e bleve atë deve për punë apo për ta ngrënë?”*

*- Për punë, iu përgjigj blerësi, e Vaile i tha:*

---

<sup>43</sup> Buhariu dhe Muslimi.

- *Ajo deve ka një plagë në këmbë që ia kam parë, e nuk do të mund të durojë rrugën!*

Blerësi e ktheu devenë, por shitësi ia zvogëloi çmimin për njëqind dërhëmë, e Vaile ia pa për të madhe shitësit, duke i thënë:

- *O i bekuar, ne ia kemi dhënë fjalën Resulallahut s.a.v.s., se do ta tregojmë të drejtën dhe do të këshillojmë të gjithë myslimanët...,*

dhe shtoi:

- *...dhe e kam dëgjuar të thotë:*

**Askujt nuk i është hallall të shesë diçka, e mos t'i tregojë të metat e mallit, e nuk i është hallall as tjetrit që i di ato të meta, të mos i tregojë.**<sup>44</sup>

Nga 'këshilla në tregti' ata kanë nënkuptuar principin: *dëshiroja vëllaut vetëm atë që e do për vete*, dhe nuk kanë besuar se kjo lartëson gradat shpirtërore, por kanë qenë të bindur që ky është kusht i përkatësisë së tyre islamit, pjesë përbërëse e besës së dhënë.

Për shumë persona, ky është obligim i vështirë, prandaj ata preferuan ibadetin duke u larguar nga njerëzit, sepse kryerja e obligimeve ndaj Allahut e njëkohësisht edhe shoqërimi me njerëz dhe puna me ta është lloj i luftës që vetëm të sinqertit (*siddik*) mund ta durojnë.

---

<sup>44</sup> Shënojnë Hakimi dhe Bejhakiu.

Kjo luftë njeriut mund t'i lehtësohet vetëm nëse është i bindur në dy pika:

1. Është i bindur që me fshehjen e të metave dhe me lavdërimin e pabazë të mallit, nuk do t'i shtohet nafaka, por do ta shkatërrojë dhe do t'ia humbasë bereqetin.

Gjithçka që ka grumbulluar me fshehje të të metave dhe me mashtrim, Allahu Teala do t'ia shkatërrojë. Thonë se njëri kishte një lopë që e milte. Qumështin ia përziente me ujë, dhe ashtu e shiste, por ndodhi një vërshim, dhe ia mbyti lopën. Një nga fëmijët e tij i tha: *“Gjithë ata ujë që i kemi shtuar qumështit u bë bashkë dhe na e mbyti lopën.”*

E Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Nëse edhe shitësi edhe blerësi janë të sinqertë dhe të ndershëm, shitblerja e tyre do të mbushet me bereqet, e nëse mshefin (të metat e mallit) dhe gënjejnë, bereqeti do të hiqet.”<sup>45</sup>**

Në një hadith tjetër, thuhet:

**“Dora (ndihma) e Allahut Teala është mbi dy tregtarë deri sa ata nuk mashtrojnë njëri-tjetrin, e kur fillojnë të mashtrojnë mes vete, Allahu e largon dorën (ndihmën) e Tij nga ta!”<sup>46</sup>**

---

<sup>45</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Hakim b. Hizam r.a.

<sup>46</sup> Shënojnë Ebu Davud dhe Hakimi nga Ebu Hurejre r.a..

Prandaj, siç nuk e pakëson pasurinë sadakaja, as mashtrimi nuk e shton atë.

Kush mendon që malli shtohet dhe pakësohet vetëm në matje, ai nuk i beson hadithit të përmendur. E kush beson që një dërhëm i bereqetshëm mund të jetë sepër për lumturi, edhe të dynjasë edhe të ahiretit, derisa njëmijë dërhëmë nga të cilët Allahu Teala e ka larguar bereqetin mund të jenë shkatërrim për pronarin e tyre, aq sa nganjëherë dëshiron të mos i ketë dhe mendon se do ta kishte më mirë pa to – ai e di edhe kuptimin e fjalëve *'pasuria nuk shtohet me mashtrim e nuk pakësohet me sadaka'*.

2. Është i bindur në hakikatin e këshillës dhe e zbaton atë me lehtësi, domosdoshmërisht duke besuar se fitimi i ahiretit është më i mirë se sa fitimi i dynjallëkut.

Dobitë e pasurisë së dynjallëkut mbarojnë me vdekje, e mbesin padrejtësia dhe barra e gjynaheve, të bëra për atë pasuri.

Si mundet njeriu i arsyeshëm të japë një thesar për atë që është e pavlerë?

I gjithë thesari është në ruajtjen e besmit. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**‘La ilahe ilallah’ do të largojë nga njerëzit zemërimin e Allahut, përderisa ata nuk i japin përparësi punëve të dynjasë mbi punët e ahiretit<sup>47</sup>,**

e në version tjetër:

**“Derisa, për hatër të selametit të fesë së tyre nuk brengosen për atë që u mungon nga dynjallëku, ‘La ilahe ilallah’ e largon nga ata zemërimin e Allahut.**

**Por kur për selametin e fesë nuk sakrifikojnë asgjë nga dynjallëku, edhe nëse thonë ‘la ilahe ilallah’, Allahu Teala u thotë atyre: ‘Po gënjeni! Ju thoni: ‘la ilahe ilallah’ por nuk jeni të bindur!’.**

Në një hadith tjetër thuhet:

**“Kush e thotë me sinqeritet ‘La ilahe ilallah’ do të hyjë në xhenet”, e kur as’habët pyetën: “Çka mendohet me sinqeritet?”, Resulallahu s.a.v.s., tha:**

**“Duke mbrojtur veten nga ato që Allahu Teala i ka bërë haram.”<sup>48</sup>**

---

<sup>47</sup> Ebu Jala dhe Bejhekiu nga Enesi, me sened daif. Shënojnë edhe Tirmidhiu dhe Hakimi, si edhe Taberani në *Evsat*, nga Ajsha r.anha.

<sup>48</sup> Taberani nga Zejd b. Ekram në veprat *el-Muxhem el-kebir* dhe *el-Evsat*, me hasen-sened.



Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

**“Kush e konsideron të lejuar (hallall) atë që është e ndaluar (haram) në Kur’an, ai nuk e beson Kur’anin!”<sup>49</sup>**

Ai që e di se këto dy çështje i ndikojnë në iman, dhe e di se imantin e vet e ka *kapital* në *tregti* për ahiret, ai nuk do të lejojë t’i shkatërrohet kapitali i përgatitur për jetën që nuk ka fund, për fitimin që do t’i shërbejë vetëm për një kohë të kufizuar.

Tregohet se njëri nga taibinët ka thënë:

*“Nëse shkoj në xhaminë plot, e dikush më pyet: ‘Cili nga këta është më i miri?’, do ta pyesja: ‘Kush këshillon më së shumti?, e po të më thotë: ‘Filani’, i kisha thënë; ‘Ai pra është më i miri mes tyre.’ E po të më pyesin: ‘Cili është më i keqi?’, do ta pyesja: ‘Kush i mashtron më së shumti?’, e kur të më thotë: ‘Ja, ky’, kisha thënë: ‘Ai është më i keqi mes tyre!’”*

Mashtrimi është haram në të gjitha llojet e shitblerjes dhe të zanatit.

Zanatliu nuk duhet ta bëjë një punë me hile për tjetrin, sikur që as vet nuk do të ishte i kënaqur me atë punë nëse dikush do t’a bënte për të. Punën e vet ai duhet ta bëjë me maturi, dhe më së miri që di, e

---

<sup>49</sup> Shënon Tirmidhiu.

më pas, nëse produkti i tij megjithatë ka ndonjë të metë, atë duhet treguar myshterisë, qartë. Vetëm në këtë mënyrë e shpëton veten nga përgjegjësia.

Një këpuçtar e pyeti Ibn Salimin:

*- Si të veproj më së drejti në shitje të këpucëve?,*

e ky iu përgjigj:

*- Mbaroi ashtu që të dyja këpucët të jenë nga materiali i njëjtë. Mos i jep përparësi të djathtës mbi të majtën, dhe astarin rregulloje mirë. Vrimat le t'i kenë afër njëra-tjetrës, dhe kurrë mos i vendos një palë këpucë mbi tjerat.*

Në këtë lloj të veprimtarisë bën pjesë edhe shkathtësia e qepjes së pahetueshme. Për këtë e kanë pyetur Ahmed b. Hanbelinë, e ai ka thënë:

*“Ai që e shet rrobën e qepur, nuk i lejohet të mos tregojë. Shitja i lejohet vetëm me kusht që blerësit t'i tregojë për qepjen. Por nëse atë rrobë nuk e ka ndër mend ta shesë, atëherë nuk ka dëm.”*

Nëse ti thua: *“Kurrë nuk do të ketë shitje nëse njeriu obligohet të tregojë për të gjitha mangësitë e mallit të vet”*, unë them:

Nuk është ashtu. Nëse tregtarit i kushtëzohet që të sjell për shitje vetëm mall cilësor, me të cilin do të ishte i kënaqur edhe sikur ta mbante për vetë, dhe

që të mjaftohet me fitim modest nga ai mall, e që në atë rast Allahu do t'i japë bereqet në atë fitim, atëherë tregtari nuk do të ketë nevojë të fshehë të metat e mallit.

Kjo është e vështirë për tregtarët, sepse nuk kënaqen me fitim më të vogël, e fitimi i madh nuk mund të arrihet pa punë të dyshimta. Megjithatë, kush vepron me principet që i përmendëm, nuk do t'i fshehë mangësitë e mallit, ashtu që, nëse i ndodhë të ketë mall jo-cilësor, të metat do t'ia tregojë menjëherë, dhe do të kënaqet me atë që e fiton prej tij.

Ibn Sirin e shiti një dele, e i tha myshterisë:

*“Dua të jem i pastër me ty lidhur me të metat e kësaj deleje; ajo i rrëzon me këmbë enët me ushqim.”*

Hasan b. Salih e shiti një skllave, e i tha myshterisë:

*“Një herë, sa ka qenë te ne, ka kollitur me gjak.”*

Pra, kështu e kanë bërë shitblerjen besimtarët. Kështu kanë vepruar ata që i janë besnik imanit të vet. Kush nuk mundet kështu të punojë, ose ta braktisë tregtinë ose le të bëhet gati për vuajtje në ahiret.

## **Të mos mashtrohet për sasinë dhe peshën**

Personi duhet që, siç matë dhe peshon për vete kur merr, njëjtë të masë e peshojë, edhe kur jep.

Allahu Teala thotë:

**“Të mjerët ata që mangu masin e peshojnë.**

**Ata që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë,**

**E kur u matin të tjerëve ose u peshojnë, u lënë mangu.”** 83-Mutaffifun: 1-3

Rruga e vetme për të shpëtuar nga ky mjerim është që, kur blenë merr më pak, e kur shet jep pak më shumë, sepse drejtësia e plotë është vështirë e arritshme, prandaj më e drejtë është që kështu të shfaq interesimin për shpëtim.

Ai që të drejtën e tij e kërkon në matje të saktë, gati se e tepron! Bile njëri pat thënë:

*- Nuk dua që me një kokërr të blejë zemërimin e Allahut!”*,

prandaj kur blente, e hiqte gjysmë kokrre, e kur shiste e shtonte një kokërr të plotë, e me këtë thoshte:

*- Mjerë ai që për një kokërr e shet xhenetin, e ai është i gjerë sa Toka e qiejt! I shkatërruar është ai që shet lumturinë për vuajtje.”*

Të tillët deri në skajshmëri janë ruajtur nga këto dhe gjëra të ngjashme, sepse këto janë veprime të padrejta, që shumë vështirë përmirësohen me teube dhe hallallim. Kjo për shkak se askush nuk mund t'i njohë të gjithë pronarët e të gjitha kokrrave, që, pasi t'i ketë blerë kokrrat, t'ju paguaj hakun pronarëve. Kjo është një punë shumë e vështirë. Prandaj kur Resulallahu s.a.v.s., blinte diçka, i thoshte atij që bënte matjen:

**“Mate, dhe shto pak përmbi masë.”<sup>50</sup>**

Fudajli e pa të birin si po pastronte një dukat që donte ta ndërronte. E pastronte me themel, duke u kujdesur për secilën gdhendje brenda saj, që, për shkak të ndytësirës që mund ta bartë me vete, të mos vije më i rëndë. Fudajli i tha:

*“Evlad, ky veprim i joti është më i hajrit se dy haxhe (nafile) e njëzet umre.”*

Dikush nga gjenerata e parë e myslimanëve ka thënë:

*“Habitem si do të shpëtojnë tregtarët dhe shitësit që shesin gjithë ditën duke bërë bé, e natën flejnë rehat.”*

---

<sup>50</sup> Shënojnë autorët e *es-Sunen*, dhe Hakimi nga Suvejd b. Kajs, dhe e konsideron sahih me kushtet e Muslimit.

Sulejmani a.s., i tha të birit:

*“Evlad, qysh futet kokrra midis dy gurëve, ashtu futet edhe gabimi midis dy tregtarëve.”*

Njëri nga njerëzit e mirë po ia falte xhenazen një të vdekuri, që për së gjalli sillej si femër, e dikush tha:

*- Ai ka qenë gjynahqar i madh!”*

Ky heshti, ai ia përsëriti fjalët, e ky i tha:

*- Ti sikur po më thua - i ka pasur dy peshore, me një ka shitur, e me tjetrën ka blerë!*

Me këtë ka dashur të thotë se gjynahet që ia përshkruanin të vdekurit janë mes tij dhe Allahut Teala, kurse gjynahet sikur të atij që peshon, janë gjynahe mes njerëzve, të cilat shumë më vështirë zgjidhen dhe i falen njëri-tjetrit.

Kërcënimi rreth peshimit është shumë më i madh.

Shpëtimi nga kjo realizohet me një kokërr ose me gjysmë kokrre. Pra kur peshon, të vendosë më shumë të asaj që peshon, në favor të myshterisë.

Rreptësisht tërhiqet vërejtja për vëmendje gjatë matjes, kurse çështja zgjidhet me atë kokërrën e plotë që e shton gjatë shitjes, ose atë gjysmë kokrre, të hequr gjatë blerjes.

Në ajetin:

**“Edhe ju mbani me drejtësi peshojën, e mos lëni mangu në peshojë.”** 55-Rahman: 9,

sipas leximit të Ibn Mesud, në vend të shprehjes ‘mbani me drejtësi’ (**bil-kist**), është shprehja ‘me gjuhë’ (**bil-lisan**).

Pra, kuptim i mundshëm:

**“Edhu ju mbani drejtë gjuhën e peshores, e mos lëni mangu në peshojë.”**

Shkurtimisht, kush nga tjetri kërkon të jetë i drejtë ndaj tij, qoftë edhe me një fjalë, e ai vet nuk është i drejtë ashtu siç kërkon për vete, edhe për të flasin fjalët e Allahut Teala:

**“Të mjerët ata që mangu masin e peshojnë.**

**Ata që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë,**

**E kur u matin të tjerëve ose u peshojnë, u lënë mangu “** 83-Mutaffifun: 1-3

Ndalesa e përmendur për matjen nuk ka të bëjë me vet matjen, por me matje të tillë ku qëllimi është të largohet nga drejtësia. Ky është rregull për të gjitha llojet e matjeve. Ai që matë çkado qoftë, i ekspozohet rrezikut që ta godasin fjalët: **“mjerë ai”**.

Secili *mukellef*<sup>51</sup>, është në gjendje të masë veprat dhe fjalët, bile edhe mendimet e veta. Mjerë ai nëse largohet nga drejtësia dhe korrektësia, e megjithatë, sikur drejtësia absolute të ishte e mundur, nuk do ta kishim ajetin:

**“Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehenemi). Kjo është vendosur prerazi nga Rabbi yt.”** 19-Merjem: 71

Askush nuk është i pafajshëm në largim prej rrugës së drejtë (sirat-i mustekim), por meqenëse shkallët e largimit prej rrugës së drejtë janë të ndara, edhe koha e qëndrimit të njerëzve në xhehenem, deri sa të nxjerrjen prej aty, do të dallojë. Disa do të qëndrojnë në zjarr vetëm sa të shkojë fjala në vend, e të tjerët me mijëra vite.

E lusim Allahun Teala që sa më shumë të na afrojë rrugës së drejtë (sirat-i mustekim), sepse ecja në këtë rrugë, pa kurrfarë devijimi, nuk mund të pritët.

Kjo rrugë është më e hollë se fija, e më e mbrehtë se shpata. Po të mos ishte kështu, ai që ecë në të vetëm drejtë, nuk do të mund të kalonte Siratin e zgjatur përmbi zjarr, që njëjtë është më e hollë se fija e më e mbrehtë se shpata.

---

<sup>51</sup> Myslimani i rritur e me mendje të shëndoshë, i ngarkuar me obligimet e fesë.



Varësisht korrektësisë së ecjes së njeriut në këtë rrugë të drejtë, do t'i lehtësohet edhe kalimi i Siratit, në Ditën e Gjykimit.

Ai që me gjëra ushqimore përzien pluhur ose diçka tjetër, e më pas këtë e matë, është prej atyre që **“kur masin, lënë mangu”**.

Secili kasap që e matë mishin bashkë me eshtra, atje ku kjo nuk është e zakonshme, edhe ai është prej atyre që **“kur masin, lënë mangu”**.

Sipas kësaj mund të gjykohet edhe për llojet tjera të matjeve. Njëjtë është me matjen që e përdorë shitësi i shtofit. Kur blenë, ai e lëshon materialin shlrë, e kur e shet, e zgjatë dhe e shtrëngon mirë, që të fitojë në dallim.

Të gjitha këto janë lënie mangu në matje, dhe si të tilla e ekspozojnë tregtarin para kërcënimit për vuajtje të rëndë.

### **Të mos fshehet diçka lidhur me çmimin**

Pra, informata të cilat, po t'i dinte myshteriu, nuk do ta blente mallin. Resulallahu s.a.v.s., e ka ndaluar që të ndalen karavanet<sup>52</sup> dhe ka ndaluar ofertën e rrejtshme me çmim më të lartë që ka për

---

<sup>52</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ibn Abbasi r.a., dhe Ebu Hurejre r.a..

qëllim që të nxisë myshterinj tjerë të paguajnë atë çmim, ose edhe më shumë.<sup>53</sup>

Me *ndaljen e karavanit* mendohet në atë që një grup njerëzish del para tyre, e shikon mallin, dhe i bindin se çmimi i atij malli në qytet është kaq e kaq. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Mos i ndalni karavanët!”**

E nëse kjo ndodhë, pronari i mallit në karavan ka të drejtë të refuzojë marrëveshjen për shitblerje pasi të arrijë në pazar. Kjo do të mund të ishte tregti e lejuar. Prandaj, nëse vërtetohet se ai që u ka prerë rrugën ka gënjyer, atëherë shitësi ka të drejtë të zgjedh se a do ta pranojë apo refuzojë marrëveshjen, e nëse e ka thënë të vërtetën, atëherë mendimet e dijetarëve dallojnë lidhur me të drejtën për ta anuluar marrëveshjen, sepse hadithi është gjithëpërfshirës, kurse mashtrimi nuk ka ndodhur.

Resulallahu s.a.v.s., *e ka ndaluar që dikush nga qyteti të shesë mall në emër të beduinëve.*<sup>54</sup>

Kjo është situata kur, për shembull, ndonjë beduin vjen në qytet me mall të cilin dëshiron ta shesë shpejt, e dikush nga qyteti i thotë: *“Lëre te unë e unë ia rris çmimin, ose pres të shtrenjtohet!”*

---

<sup>53</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ibn Omeri r.a., dhe Ebu Hurejre r.a..

<sup>54</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ibn Abbasi r.a.. Ebu Hurejre dhe Enesi r.a..

Nëse bëhet fjalë për ushqim, kjo është haram, e për mall tjetër, mendimet janë të ndara. Mbizotëron qëndrimi për ndalimin për shkak të gjithëpërfshirjes së hadithit, si edhe për shkak që me një vonesë e tillë në shitje ka për qëllim të shkaktohet mungesë të atij malli te populli, e as ky që po e krijon këtë situatë, nuk do të kishte hajr prej kësaj.

Resulallahu s.a.v.s., ka ndaluar ofertën e rrejtshme të çmimit më të lartë me qëllim që të tërhiqen myshterinj tjerë të paguajnë atë çmim, ose më shumë.

Ky është rasti kur personi i caktuar i ofron një çmim shitësit në prani të myshterisë që dëshiron ta blejë atë mall të njëjtë me çmim më të lartë. Ky i pari as nuk e ka nijet ta blejë mallin, por vetëm nxitë myshterinë ta blejë atë mall me çmim më të lartë.

Një veprim i tillë, nëse nuk është në marrëveshje me shitësin, është haram për atë që bën ofertën, kurse vet shitja që mund të rezultojë nga kjo, është e lejuar.

E nëse kjo bëhet në marrëveshje me shitësin, mendimet ndahen lidhur me të drejtën e zgjedhjes së myshterisë për të anuluar atë marrëveshje.

Dominon mendimi për t'i lejuar myshterisë të drejtën për ta anuluar, sepse kemi të bëjmë me shtrembërim të fakteve, njëjtë sikur në rastin kur lopa që jep qumësht nuk mjelet disa ditë me qëllim që të grumbullohet qumështi, e në kohën e shitjes të lavdërohet si lopë që jep shumë qumësht, ose ky rasti kur i prehet rruga karavanit dhe gënjehet për çmimin e mallit.

Këto ndalesa dëshmojnë se nuk mund t'i lejohet as shitësit e as myshterisë të mashtrojnë me çmimin aktual të mallit, e as të fshehet çkado, që sikur të dihej, do të ndërpriste marrëveshjen. Një fshehje e tillë është mashtrim, e mashtrimi është haram, dhe është e kundërta e sinqeritetit, e sinqeriteti është obligim.

Tregohet se njëri nga taibinët (Junus b. Ubejdu'l-Basri) ishte tregtar në Basra. E kishte një punëtor në qytetin Sus të Horasanit, që e furnizonte me sheqer. Punëtori i kishte shkruar një porosi:

*- Këtë vit kallami jonë është dëmtuar, prandaj blej sheqer atje dhe magazino sheqerin.*

Ky bleu tërë sasinë e sheqerit nga një tregtar në qytetin e vet (Basra), e kur erdhi koha e shitjes, fitoi tridhjetë mijë dërhëmë. U kthye në shtëpi, dhe gjithë natën e kaloi në mendime, duke thënë me vete:

- *I fitova tridhjetë mijë, kurse e shkatërrova sinqeritetin e një myslimani.*

Herët në mengjes, shkoi te shitësi i sheqerit, ia dha tridhjetë mijë, dhe i tha:

- *Allahu të dhashtë bereqet në to!*

Shitësi i sheqerit pyeti se nga erdhën ato, e ky ia ktheu:

- *Të kam fshehur të vërtetën. Në atë kohë çmimi i sheqerit ishte në rritje,*

e tregtari i tha:

- *Allahu bëftë rahmet me ty! Tash që më tregove, unë po t'i bëj hallall!*

Ky, bashkë me paratë përsëri u kthye në shtëpi, dhe prapë mbeti pa gjumë gjithë natën dhe mendonte:

- *Prapë nuk isha i sinqertë! Ndoshta vetëm u turpërua, prandaj m'i dha mua paratë.*

Herët në mëngjes prapë shkoi te tregtari, e i tha:

- *Allahu të ruajt! Merri paratë tua, kjo është më mirë për zemrën time.*

Dhe tregtari në fund i morri ato tridhjetë mijë.

Këto transmetime na tregojnë se njeriu nuk ka të drejtë të shfrytëzojë rastin e as naivitetin e atij që e posedon mallin, nuk ka të drejtë të mos i thotë shitësit për shtrenjtimin, ose blerësit për zbritjen. Po ta bënte këtë, atëherë është duke gabuar, nuk është

duke vepruar drejtë, dhe nuk ua do të mirën myslimanëve.

Nëse shet diçka, e thotë: *“Po e shes aq sa më kushton edhe mua”*, ose *“aq sa i kam paguar”*, duhet të jetë i sinqertë me këtë.

Duhet treguar mangësitë e mallit, nëse ka. Nëse ka blerë diçka deri në një afat të caktuar, edhe për këtë duhet treguar, e nëse e ka blerë nga fëmija i vet ose nga miku në afat të pacaktuar, edhe këtë duhet përmendur.

Myshteriu zakonisht bazohet në atë që i thuhet, e nuk mendon vet. Prandaj është obligim që të njohet mirë, sepse ai po mbështet në besimin tënd.

## Kapitulli i katërt

### MIRËBËRJA NË TREGTI

Allahu Teala ka urdhëruar edhe drejtësi edhe mirëbërje.

Drejtesia është i vetmi shkaktar i shpëtimit, dhe për shpëtim është sikur kapitali për tregtinë. Kurse mirëbërja është shkaktar i suksesit dhe lumturisë së përjetshme, e kjo është sikur fitimi në tregti.

Nuk mund të konsiderohet i arsyeshëm ai që në tregti të dynjallëkut mjaftohet vetëm me kapitalin, pa bërë fitim. Edhe në punët e ahiretit, besimtari nuk duhet të kufizohet vetëm në drejtësi dhe largim nga padrejtësia, e të mbyllë dyert e mirëbërjes.

Allahu Teala urdhëron:

**“...Dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë mirë Allahu ty...”** 28-Kasas: 77,

Me një ajet tjetër:

**“...Vërtet, mëshira e Allahut është afër bamirësve.”** 7-Araf: 56

Edhe me një ajet tjetër:

**“..Allahu urdhëron drejtësi, mirëbërje...”**

16-Nahl: 90,

Me shprehjen *ihsan* (mirëbërje) mendojmë ne aktin që do t'i bëj dobi myshterisë, e që nuk është detyrim (*vaxhib*), por është shprehje e mirësisë nga ana e tregtarit. Detyrim (*vaxhib*) është të vepruarit me drejtësi dhe largimi nga padrejtësia, për çka tashmë folëm.

E mirëbërja në tregti arrihet në gjashtë situata:

**E para** është largimi nga fitimi i tepruar.

Padyshim që malli shitet për fitim. Siç mund të caktohet kufiri më i lartë i fitimit, njëjtë mund të veprohet edhe me çmimin më të ulët. Nëse myshteriu ofron më shumë para se që është çmimi i zakonshëm për një mall, shkak është mosdituria, ose që i pëlqen malli, ose që për momentin i nevojitet shumë, e shitësi do të duhej të hezitojë që të marrë tepricën.

Një veprim i tillë është mirëbërje, por përderisa nuk ka mashtrim, marrja e asaj teprice nuk është padrejtësi.

Një pjesë e alimëve mendon se përdorimi i papërvojës dhe paditurisë së blerësit që sjell fitim më shumë se një e treta, gjithsesi me vete tërheqë të drejtën e blerësit për ta anuluar atë marrëveshje.



Sipas nesh, shitblerja është e drejtë dhe myshteriu nuk mund ta anulojë këtë marrëveshje. Por shitja me limit të ulët të fitimit, deri në përqindje të pranueshme e çmim të zakonshëm, është mirëbërje.

Junus b. Ubjed kishte disa xhybe me çmime të ndryshme. Një lloj ishte katërqind, e tjetri dyqind.

Junusi shkoi në xhami për namaz, e në dyqan e la vëllanë më të ri. Aty shkoi një beduin, kërkoi xhybe nga ato që kushtonin katërqind, por djaloshi ia tregoi një që ishte dyqind. Këtij i pëlqeu, dhe e bleu. U nis të largohej me xhyben në dorë, e rrugës u takua me Junusin. Ky e njohu mallin e vet, dhe e pyeti beduinin:

- *Sa e bleve?*, e beduini iu përgjigj:

- *Katërqind.*

Junusi i tha:

- *Nuk kushton më shumë se dyqind, ktheja!*

Por beduini i përgjigj:

- *Tek ne kjo kushton pesëqind, unë jam i kënaqur.*

Junusi ishte i vendosur:

- *Hajde me mua, sinqeriteti në iman është më i rëndësishëm se gjithë dynjallëku, me krejt çka ka!*

Shkuan në dyqan dhe Junusi ia ktheu dyqind dërhemë. Më pas e goditi vëllanë e vet, duke e qortuar:

- *Si nuk të vjen turp?! A nuk ke frikë nga Allahu?!  
Pranon fitimin mbi vlerë të mallit, e refuzon  
sinqeritetin ndaj myslimanëve!”*

Djaloshi i tha:

- *Vallahi, ai e morri sepse ishte i kënaqur, edhe  
me çmim edhe me mall!, e Junusi iu përgjigj:*

- *Pse nuk u sille me të siç do të doje të silleshin  
me ty?*

Të fshihet çmimi e të bëhet mashtrim, është  
padrejtësi, për çka tashmë folëm.

E në hadith, thuhet:

**“Të mashtrohet personi i paaftë (që  
marrëveshjen e lë në ndërgjegje të shitësit) është  
haram.”<sup>55</sup>**

Zubejr b. Adijj pohon:

*“I takova tetëmbëdhjetë as’habë, e që asnjëri  
prej tyre nuk dinte të blinte as mish për një dërhem.”*

Prandaj të mashtrohet blerësi që mbështetet në  
ndërgjegjen e shitësit është zullum.

---

<sup>55</sup> Taberani, nga Ebu Umame, me sened daif, kurse Bejhekiu nga Xhabiri, me sened të mirë, por në vend të ‘haram’ thuhet ‘kamatë’.

Ndërsa shitja me çmim më të lartë është largim nga mirëbërja. Fatkeqësisht, tregtarët që bëjnë pazarllëk pa hile e mashtrim, janë të rrallë.

Shembulli më i mirë i mirëbërjes është ky tregim:

Serijus Sakati i bleu gjashtë ngarkesa bademë për gjashtëdhjetë dinarë, e në fletore i shënoi tre dinarë fitim, duke llogaritur gjysmë dinari fitim për çdo dhjetë dinarë.

Në ndërkohë, çmimi u ngrit e ajo sasi bademësh tash kushtonte nëntëdhjetë dinarë. Erdh një tregtar i devotshëm dhe pyeti për çmim, e ky i tha:

- *Gjashtëdhjetë e tri.*

Tregtari i tha:

- *Kjo sasi tani kushton nëntëdhjetë!*

Sakati i tha:

- *Le të jetë, unë kam vendosur, i shes vetëm për gjashtëdhjetë e tri*

Tregtari i tha:

- *Edhe unë iu kam betuar Allahut se nuk do të mashtroj vëllanë mysliman. E blej mallin prej teje vetëm për nëntëdhjetë!”*

As tregtari nuk bleu, e as Sakati nuk shiti. Kjo është mirëbërje nga të dy anët, ku secili e njihte hakikatin.

Tregohet se Muhammed b. Munkedir kishte për shitje disa copa të pëlhurës me gjatësi të ndryshme. Disa kushtonin pesë e disa gjashtë. Në mungesë të tij, djaloshi që punonte tek ai, e shiti një copë që kushtonte pesë, për dhjetë. Kur dëgjoji për këtë, Munkedir gjithë ditën e kërkoi blerësin beduin. E gjeti, dhe i tha:

- *Djaloshi ka bërë gabim; atë që kushton pesë ta ka shitur për dhjetë.* Beduini ia ktheu:

- *Por unë jam i kënaqur me këtë!*, e Munkedir i tha:

- *Ti je i kënaqur, por ne nuk të dëshirojmë ty atë që nuk ia dëshirojmë vetes. Zgjedh njërën për ata dërhëmët e tu: ose merr diçka që vlenë dhjetë, ose t'i kthejmë pesë, ose ta kthesh pëlhurën tonë e t'i marrësh paratë tua.*

Beduini zgjodhi t'i kthehen pesë dërhëmë, e Munkedir ia dha paratë.

Kur Munkedir u largua, beduini pyeti:

- *Kush është ky person?*, e kur i treguan që është Muhammed b. Munkedir, beduini kërcëu, e tha:

- *La ilahe ilallah! Ky është ai që, kur merr thatësirë, për nder të tij e lusim Allahun të na dhurojë shi!*

Kjo quhet mirëbërje! Që në dhjetë dërhëmë të mos dëshirohet fitim më i madh se gjysëm ose një dërhemi, varësisht traditave.

Kush kënaqet me pak fitim, i shtohet puna, puna e shton dobinë, e bashkë me mirëbërjen shkon edhe bereqeti.

Alia r.a. sillej nëpër pazarin e Kufe's me kamxhik në dorë, dhe thoshte:

*“O tregtarë, merrni vetëm aq sa keni të drejtë, e do të shpëtoni. Mos mohoni fitimin e vogël, që i madhi t’ju refuzohet!”*

E pyetën Abdurrahman b. Avfa-n, r.a.:

*- Çka është sebepi i pasurisë tënde?”*

Abdurrahman b. Avfa, r.a. tha:

*- Tri gjëra: kurrë nuk refuzoj fitimin e vogël, as nuk e vonoj shitjen e kafshës që më kërkohet, as nuk shes veresie.*

Thuhet se njëherë ai ka shitur njëmijë deve me çmimin e blerjes, por pastaj i shiti fretë, e për secilin fre fitoi nga një dirhem dhe ushqim për një ditë, e në këtë mënyrë ishte në fitim dymijë dërhëmë.

Kjo është ustallëk në tregti!

***E dyta*** është pranimi i çmimit më të lartë.

Shembull: kur blenë nga dikush me gjendje të dobët ose që është fukarâ, dhe me vetëdije pranon çmimin më të lartë, që t’i ndihmojë në përmirësimin (ekonomik) dhe t’ia lehtësojë shitjen - edhe kjo është mirëbërje në shitblerje.

Ky person renditet mes atyre për të cilët Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Allahu Teala lëshon rahmet mbi robin që lehtë shet e lehtë blenë.”**

E nëse blenë nga tregtari i pasur, i cili shet me çmim të lartë, atëherë nuk është mirë të pranojë atë çmim. Kjo është vetëm humbje e pasurisë, që as nuk ka dobi e as nuk është e lavdëruar.

Në një hadith që përcillet përmes Ehli-bejtit, thuhet:

**“Ai që mashtrohet në blerje, as nuk lavdërohet e as nuk shpërblehet.”<sup>56</sup>**

---

<sup>56</sup> Shënon Tirmidhiu, si dhe Hakimi në veprën ‘*Nevadir*’, nga Ubejdullah b. Hasan, ai nga babai i vet, e ai nga gjyshi. Shënon edhe Ebu Ja’la nga Husejn b. Ali r.a.

Iljas b. Muavi b. Kure, kadiu i Basras dhe një nga mendimtarët më të shquar nga taibinët, thoshte:

*“Unë nuk jam mashtrues dinak, e as që mashtruesi dinak mund të më mashtrojë. Nuk mund të më mashtrojë as Ibn Sirin, por Hasan Basriu dhe babai im mashtrohen.*

Veprim i përkryer është të mos mashtrosh dhe të mos lejosh të mashtrohesh.

Dikush kështu e përshkruante Omerin r.a.:

*“Ishte aq i ndershëm sa askënd nuk e mashtronte, dhe aq i mençur të mos lejohet që ta mashtrojnë.”*

Hasani dhe Husejni, r.a., si edhe të zgjedhurit e tjerë nga gjeneratat e para, ishin shumë të kujdesshëm në blerje, bërin pazarllëk, e në përfundim dhuronin nga pasuria e tyre. Njërit prej tyre i thanë:

*- Aq shumë bën pazarllëk për të ulur çmimin, e më pas jep më shumë, dhe aspak nuk brengosesh!, e ky ua ktheu:*

*- Të mashtrohesh është budallallëk, e dhurata është virtyt.*

Njëri nga ta thotë:

*“Kur mashtrohem, llogaritet si budallallëku im, jo si dhuratë. E kur jap dhuratë – e bëj në emër të Allahut, e aty nuk mashtrohem.”*

**E treta** është në të paguarit e çmimit dhe borxheve të tjera.

Mirësia në këtë nganjëherë është në falje dhe në zvogëlim të një pjese (të çmimit), nganjëherë në zgjatjen e afatit për pagesë, e nganjëherë në lehtësim kur kërkohet pagesa.

Të gjitha këto veprime janë të pëlqyeshme dhe në këtë inkurajohemi, ngase Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Allahu Teala e mëshiroftë robin që lehtë shet e lehtë blenë, që lehtë paguan borxhin dhe lehtëson kur merr borxhin.”<sup>57</sup>**

Njeriu duhet të përfitojë nga kjo dua e Resulallahut s.a.v.s..

E Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

**“Bëhu zemërgjerë, (që edhe ndaj teje të jenë zemërgjerë)”<sup>58</sup>,**

---

<sup>57</sup> Buhariu nga Xhabiri r.a.



dhe thotë:

**“Ai që i zgjatë afatin atij që është në situatë të vështirë, ose ia fal krejt borxhin, Allahu Teala ia lehtëson dhënien e llogarisë,**

e në transmetim tjetër:

**“...Allahu Teala e vendos nën hijen e Arshit, në ditën kur nuk do të ketë hije tjetër...”<sup>59</sup>**

Resulallahu s.a.v.s. tregon:

**“Personi që i ka bërë vetes zullum në dynja, në ditën e kijametit kur jep llogari, nuk i gjendet asnjë vepër e mirë dhe pyetet:**

***‘A ke bërë ndonjëherë ndonjë të mirë?’,***

**e ai përgjigjet:**

***‘Jo, pos që u jepja njerëzve hua, e punëtorëve u thosha - ndaj atij që nuk ka vështirësi me pagesë bëhuni zemërgjerë, e atij që ka vështirësi jepni afat më të gjatë’.***

**Në këtë, Allahu Teala thotë:**

***‘Unë kam obligim më të madh për këtë, kapërcejeni robin Tim’.*”<sup>60</sup>**

---

<sup>58</sup> Taberani, nga Ibn Abbasi r.a., me transmetues të besueshëm.

<sup>59</sup> Shënon Muslimi, në një version tjetër, nga Ebu’l Jusra Ka’b b. Amr r.a..

<sup>60</sup> Muslimi, nga Ebu Mesud el-Ensari r.a., Buhariu dhe Muslimi nga Hudhejfe r.a.në version të ngjashëm.

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

**Kush i jep dikujt para borxh me afat, për çdo ditë i shkruhet sadaka, deri në afat. E nëse borxhliu nuk e kthen borxhin në afat, e ky borxhli i jep afat shtesë, për secilën ditë të pritjes i shkruhet sadaka në vlerë të atij borxhi.**<sup>61</sup>

Bile nga gjeneratat e para ka pasur edhe të tillë që, duke iu përshtatur këtij hadithi, për të përfituar sadaka për secilën ditë të pritjes, nuk dëshironin t'ju kthehet borxhi në afat.

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**E kam parë të shkruar në portë të xhenetit:**

***'Sadakaja shpërblehet dhjetë, e huazimi tetëmbëdhjetë fish'***<sup>62</sup>

Thonë se kjo është kështu për shkak që sadakaja shkon në duar të atij që ka nevojë, por edhe të atij që nuk ka nevojë, kurse poshtërimin e kërkimit të huasë e duron vetëm ai që vërtetë ka nevojë.

---

<sup>61</sup> Shënon Ibn Maxhe, nga Burejde r.a. Shënojnë edhe Ahmedi dhe Hakimi, që thotë se është sahih, me kushtet e Buhariut dhe Muslimit.

<sup>62</sup> Ibn Maxhe, nga Enesi.

Resulallahu s.a.v.s., i pa dy persona (Abdullah b. Hadred dhe Kab b. Malik) duke debatuar për borxh dhe borxhdhënësit (Kab b. Malik) i tha:

- **Falja gjysmën!**,

e borxhlië (Abdullahut) i tha:

- **Ngritu e paguja gjysmën.**<sup>63</sup>

Secilit që shet diçka, e më pas e shtyen pagesën dhe nuk bëhet i ashpër në kërkim të borxhit, ai veprim do t'i vlerësohet si huazim.

Tregohet se Hasan Basriu e shiti mushkën e vet për katërqind dërhëmë.

Kur i kërkoi paratë e veta, myshteriu i tha:

- *Bëhu zemërgjerë, o Ebu Seid!*

Hasani i tha:

- *Po ta ulë çmimin për njëqind, e ky i tha:*

- *Bëhu edhe mirëbërës, o Ebu Seid!*, e Hasani i

tha:

- *Po ta fali edhe njëqindëshin tjetër, dhe i mori vetëm dyqind.*

I thanë:

- *O Ebu Seid, kjo është vetëm gjysma e çmimit, e ai u përgjigj:*

- *Kjo është mirëbërësi.*

---

<sup>63</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ka'b b. Malik r.a.

Në një transmetim, thuhet:

**Merre hakun – qoftë shuma tamam apo e mangët – merre, hallall e ligjshëm, dhe pa thënë fjalë të keqe, e Allahu do ta mundësojë që lehtë të japësh llogari për veprat tua.**<sup>64</sup>

***E katërta*** është pagesa e plotë e borxhit.

Mirëbërje në këtë është që pagesa e borxhit të bëhet në mënyrën më të mirë.

Për shembull, borxhliu shkon te borxhdhënësi, dhe kështu e kursen atë nga parehatia që t’u kërkojë hakun e vet. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Më i miri mes jush është ai që në mënyrën më të mirë e paguan borxhin e vet.”**<sup>65</sup>

Borxhin duhet ta paguajë sapo të jetë në gjendje për këtë, qoftë edhe para afatit. Do të japë me më shumë mirësi se sa që kërkohet, e nëse nuk mund ta kthejë, e bën nijet që ta bëjë sapo t’i jepet mundësia. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Kush merr borxh me nijet që ta kthejë, Allahu Teala i cakton melaqe që e ruajnë e luten për të, deri sa ta kthejë borxhin.”**<sup>66</sup>

---

<sup>64</sup> Shënon Ibn Maxhe, nga Ebu Hurejre r.a., me hasen-sened. Ibn Hibban dhe Hakimi shënojnë hadith të ngjashëm, dhe thonë se është sahih, nga Ibn Omeri r.a. dhe Ajsha r.anha.

<sup>65</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejre.

Disa myslimanë nga gjeneratat e para, (selef-i salihin) për shkak të këtij hadithi, kërkonin hua edhe pa pasur shumë nevojë.

Sado ashpër të sillet borxhdhënësi, borxhliu duhet butë ta pranojë dhe t'ia kthejë me të mirë, siç ka vepruar edhe Resulallahu s.a.v.s. kur, pas kalimit të afatit të borxhit nuk e kishte paguar, e i erdh borxhdhënësi (çifut) dhe iu drejtua ashpër. As'habët deshën t'i vërsulen, por Resulallahu s.a.v.s., u tha:

**“Lëreni! Borxhdhënësi ka të drejtë të flasë!”<sup>67</sup>**

Çfarëdo që të jetë biseda mes borxhliës e borxhdhënësit, mirëbërja shihet në atë që ndërmjetësit të jenë shumë më të sjellshëm e të matur me borxhlinë; borxhdhënësi jep hua pasi që ka mjaft, por borxhliu kërkon sepse ka nevojë.

Njëjtë edhe myshteria përkrahet më shumë, sepse shitësi shet për fitim, ndërsa blerësi blenë sepse ka nevojë.

Kjo është sjellje më e mirë, por nëse borxhliu bën padrejtësi, atëherë i ndihmohet të mos hyj në këtë rrezik dhe duhet t'i tërhiqet vëmendja.

---

<sup>66</sup> Shënon Ahmedi, nga Ajsha r.anha, si edhe Taberani, në *e/-Evsat*.

<sup>67</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejre.

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

- **Ndihmoje vëllanë tënd kur ai bën zullum dhe kur i bëhet zullum atij.** Një as'hab e pyeti:

- Si t'i ndihmoj zullumqarit?,

e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **I ndihmoni duke e ndaluar atë nga zullumi.**<sup>68</sup>

**E pesta** është anulimi i marrëveshjes për shitblerje.

Personi që kërkon anulim nuk duhet të refuzohet. Sepse anulimin do ta dëshirojë vetëm ai që është pishman (për blerjen), ose mendon që është mashtruar.

Nuk është e drejtë të bëhesh shkaktar për dëmtimin e tjetrit.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Kush ia lejon anulimin e marrëveshjes atij që është bërë pishman, Allahu Teala, në Ditën e Gjykimit, do t’ia falë gabimet.”**<sup>69</sup>

**E gjashta** është dhënia veresie fukarëve me nijet që nga ta nuk do të kërkojë pagesë nëse ata nuk mund ta kthejnë borxhin.

---

<sup>68</sup> Buhariu dhe Muslimi, nga Enesi r.a.

<sup>69</sup> Shënojnë Ebu Davud dhe Hakimi, nga Ebu Hurejre, I cili pohon se është sahih, me kushtet e Muslimit.

Tregtarët e gjeneratave të para të Islamit (*selef-i salihin*) kishin dy fletore, e në njëjërën shënonin njerëzit e panjohur.

Për shembull, fukarāja sheh ushqim ose pemë, e dëshiron shumë, por tregon që nuk ka para e shitësi shënon në fletoren e personave të panjohur duke i thënë: “*Merri, e paguan kur të mundesh.*”

Por as këtë sjellje nuk e llogaritnin si veti të mirë. Veti të mirë e llogaritnin rastin kur as nuk e shënonin në fletore emrin e atij fukaraje, e as që e konsideronin këtë si borxh, duke i thënë: “*Merr çka do, nëse ndonjëherë të jepet mundësia, e paguan, e nëse nuk mundesh – hallall e ke!*”

E tillë ka qenë mënyra e tregtisë së myslimanëve nga gjeneratat e para, por kjo mënyrë tashmë është shuar. Kush do të arrinte ta nisë përsëri këtë mënyrë, do të ishte ripërtëritës i atyre praktikave.

Thënë shkurt, tregtia është një lloj testi për njerëzit, me të cilin matet niveli i besnikërisë së tyre ndaj fesë, pra devotshmëria e tyre.

Në këtë çështje, poeti ka thënë:

***Mos t’mashtrojë këmishë e arnuar,  
po as mantel me oja,  
as gjurma e namazit n’ballë,  
veç paratë tregoja.  
A është i devijuar, a i devotshëm,  
fshehtësinë mësoja.***

Njerëzit gjithashtu thonë:

*“Nëse dikë e lavdërojnë komshitë e lagjes, shokët që kanë udhëtuar me të dhe tregtarët e çarshisë, mos dysho në mirësinë e tij.”*

Para Omerit r.a., doli njëri që duhej të dëshmonte, e Omeri i tha:

- *Sjell dikë që të njeh!* Ky e solli një person, e Omeri r.a. e pyeti:

- *A i je ti komshiu i parë, dhe e di se kur vjen në shtëpi e kur del nga shtëpia?* Personi u përgjigj.

- *Nuk jam,* e Omeri r.a. e pyeti:

- *A ke udhëtuar me të, e mund të flasësh për vlerat e tij morale?* Personi tha:

- *Jo,* e Omeri r.a. prapë e pyeti:

- *A mos ke punuar me të me dinarë e dërhëmë - sepse aty më së miri tregohet devotshmëria e dikujt?”* Ky prapë u përgjigj me jo, e në këtë, Omeri r.a., tha:

- *Mendoj se ti e ke parë këtë në xhami, se si para njerëzve lexon Kur’an, dhe nganjëherë e çon kokën poshtë e lartë.”* Personi e pohoi, e Omeri r.a., i tha:

- *Shko, ti nuk di asgjë për këtë njeri.* Pastaj u kthye kah ai që duhej të ishte dëshmitar, dhe prapë i tha:

-*Shko, dhe sille dikë që të njeh!*



## Kapitulli i pestë

### **KUJDESI I TREGTARIT PËR AHIRETIN DHE IMANIN E VET**

Tregtari nuk guxon të preokupohet aq shumë me dynjanë sa të mos ketë kohë të mendojë e të kujdeset për ahiretin, sepse kjo botë është e përkohshme.

Fitimin për ahiret nuk mund ta kompenzojë me fitim të dynjallëkut, e mund të ndodhë që dynjanë ta fitojë duke e paguar me ahiret.

I mençuri do të kujdeset për vete, e këtë do ta arrijë duke u kujdesur për kapitalin e vet. Kapitalin e ka edhe pjesë të imanit, edhe punë.

Nga gjeneratat e para të myslimanëve, është thënë:

*“Për të mençurin, përparësi ka ajo që më së shumti i duhet në këtë dynja, e në dynja më së shumti i duhet ajo që do t’i sjell dobi dhe punë të lavdërueshme në ahiret.”*

Muadh b. Xhebel r.a. në këshillën e tij ka shkruar:

*“Ty të duhet hisja jote në dynja, por hisja në ahiret të duhet edhe më shumë. Prandaj, kujdesu një herë për hisen e ahiretit dhe fitoje atë, e rrugës do ta takosh edhe hisen tënde të dynjasë,e edhe asaj rrij gati.”*

Edhe Allahu Teala thotë:

**“E mos harro hisen tënde në këtë botë”**

28-Kasas: 77,

pra, mos harro në këtë botë (dynja), hisen tënde për ahiret. Dynjaja është arë e ahiretit, të mirat fitohen në dynja.

E tregtari do t’a ruaj fenë e vet, duke u kujdesur për shtatë gjëra:

1. Të ketë nijet të mirë dhe besim kur të fillojë në tregti.

Le ta bëjë nijet se në atë punë do të përmbahet nga lypësaria, që nuk do të lakmojë të tjerët por do ta kërkojë hallallin, që me fitim do ta ndihmojë imanin e vet e t’i plotësojë nevojat e familjes, e me këtë të hyjë në radhët e trimave që jetojnë me drejtësi.

Le ta bëjë nijet të jetë i singertë me myslimanët, duke u dëshiruar atyre atë që ia dëshiron edhe vetes.

Le ta bëjë nijet që në punën e tij të ndjekë rrugën e drejtësisë e të mirëbërjes, që e shpjeguam.

Le ta bëjë nijet të urdhërojë të mirën e ta ndalojë të keqen në gjithçka që sheh në punë.

Nëse arrin të ruajë këso bindje e synime, do të jetë një nga ata që punojnë në rrugë të ahiretit.

E nëse krahas kësaj edhe fiton diçka prej dynjasë, atë e ka fitim shtesë që, kur i humbet, prapë do ta ketë fitimin e ahiretit.

2. Me zanatin a tregtinë e tij të ketë qëllim të plotësojë një nga obligimet e xhematit (*farzi-kifaje*), sepse zanati dhe tregtia janë *farzi-kifaje* dhe po të braktisen ato, do të mungonin gjërat elementare, e do të shkatërroheshin njerëzit.

Rregulli në dynja është i mundshëm me ndihmë të ndërsjellë dhe me detyra të caktuara. Nëse të gjithë do të merreshin me të njëjtën punë, e punët tjera t'i braktisinin, jeta do të paralizohet.

Bile, në këtë kuptim disa e kanë interpretuar edhe hadithin e Resulallahut s.a.v.s.:

**“Dallimi përbrenda ummetit tim është rahmet.”<sup>70</sup>,**

pra rahmeti është në punët e ndara dhe në interesime për profesione të ndryshme.

---

<sup>70</sup> E kemi përmendur në *Librin për diturinë*.

Disa zanate janë tepër të rëndësishme. Ka disa pa të cilët edhe bëhet, sepse ndërlidhen me luks, teprim e stolisje të dynjallëkut.

Myslimani duhet të merret me zanat të tillë që, ai angazhim të jetë i dobishëm për myslimanët tjerë dhe i rëndësishëm për imanin e vet.

Do të duhej të largohet nga zanatet si qëndisja, bojaxhiu, puna me gips dhe zanatet tjera me të cilat vetëm zbukurohet dynjaja. Zanatet e këtilla nuk u kanë pëlqyer fetarëve.

Sa i përket prodhimit të instrumenteve muzikore dhe veglave të ngjashme që janë haram, largimi nga puna me to është sikur largimi nga zullumi e padrejtësia.

Njëjtë është për qepjen e rrobave prej pëlhurës për meshkuj, përpunimin e arit dhe argjendit për të stolisur shalën e kalit ose për të bërë unazë prej arit për meshkuj. Puna në to është gjynah, e fitimi prej tyre – haram.

Për stoli është përcaktuar zeqat, por që nuk i përfshinë stolitë për meshkuj sepse ato janë haram. Edhe nëse bëhet si stoli femrash, e prapë synohet të bartet nga mashkulli, kjo nuk e bën të lejuar, sepse rregulli është caktuar lidhur me qëllimin e përdorimit.

Më herët kemi treguar që nuk është e lavdërueshme të shitet ushqimi, e as qefini, sepse kjo kërkon të dëshirohen krizat që shkaktojnë rritje çmimesh dhe të dëshirohet vdekja e njerëzve.

Për myslimanin nuk është e lavdëruar as të jetë kasap, sepse kjo e ashpëron zemrën, e as nga ata që lëshojnë gjakun ose pastrues, sepse kjo kërkon përzierje me papastërti. Njëjtë është me atë që thanë lëkura kafshësh, e zanate të ngjashme.

Ibn Sirrin nuk i donte tellallët, kurse Katade e shihte si të papëlqyer marrjen e kompenzimit për atë veprimtari<sup>71</sup>.

Arsye për këtë, me siguri është fakti se besueshmëria është e vogël që tellali t'i ikë gënjeshtërisë ose lavdërimit të tepruar të ndonjë malli, por edhe për faktin që një veprimtari të tillë nuk mund t'i caktohet vlera: nganjëherë folë më shumë, e nganjëherë më pak, ndërsa adet është që pagesa nuk varet nga të folurit e tij, por nga vlera e shitjes së mallit, e kjo është një lloj zullumi. E drejta e tij është të marrë pagesë sipas punës dhe lodhjes.

Myslmanët e hershëm (si Hasan Basriu, Ibn Sirrini e të tjerët) e shihnin si të papëlqyer edhe shirblerjen e kafshëve të gjalla me qëllim të stërshitjes, sepse atëherë shitësit nuk i pëlqen

---

<sup>71</sup> Tellall: ai që shet në pazar mallin e tjetrit.

vendimi i Allahut Teala për ngordhjen e tyre, e që është e paevitueshme. Për këtë, Arabët thonë: *“Shite një kafshë e blej dy vdekje.”*

Të parët nuk e donin as punën e këmbyesit (bankierit), sepse në këtë veprim vështirë shpëtohet nga kamatat e imëta.

Kjo kërkon edhe njohjen e detajeve që nuk ndërliidhen me vetë mallin, por me tregun e gjerë të mallit.

Këmbyesi (bankeri) rrallë arrinë fitim të plotë, sepse kjo ndodhë vetëm kur myshteriu nuk i di detajet e mallit që po e shkëmben.

Prandaj këmbyesi rrallë mbetet i drejtë, edhe nëse është shumë i kujdesshëm në punën e tij. Nuk është e lavdërueshme që këmbyesi të shkrijë paratë e arit dhe argjendit e t’i përpunojë për stolisje, por, vetëm kur dyshon në rregullsinë e saj, e shkrinë dhe e përdorë në metalet tjera. Ahmed b. Hanbel r.a., thotë:

*“Për këtë kemi ndalesë nga Resulallahu s.a.v.s. dhe as’habët e tij<sup>72</sup>, e edhe për mua nuk është e pëlqyeshme.”*

---

<sup>72</sup> Shënojnë Ebu Davud, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Alkam b. Abdullah, e ai nga i ati.

Hanbeliu thotë:

*“Mënyra më e mirë e kësaj është të blehen me para të arit paratë e argjendit, e pastaj me paratë e argjendit blehet kallëp ari, e më pas e perdor arin aty ku dëshiron, dhe në këtë mënyrë shpëton nga kamata.”*

Të parët e donin tregtinë me tekstil. Seid b. Musejjib thotë:

*“Tregtia më e dashur për mua është ajo me tekstil, nëse nuk bëhet bé për të.”*

Transmetohet nga Resulallahu s.a.v.s.:

**“Tregtia më e mirë për ju është tregtia me tekstil, e profesioni më i mirë, ai i qepësit.”<sup>73</sup>,**

e në hadith tjetër thuhet:

**“Sikur xhenetlitë të bënin tregti, do të punonin me stof, e xhehenemlitë me këmbim parash.”<sup>74</sup>**

Më të mirët nga gjeneratat e para të myslimanëve angazhoheshin kryesisht në këto zanate: këpuctari, tregti, transport, rrobaqepësi, lëkurëpunues, zbardhje të pëlhurës, prodhim të mesteve e nallaneve, farkëtari, tjerrje, gjueti e peshkim, si edhe kaligrafi.

---

<sup>73</sup> Shënon autori i *Firdevs*, nga Ali b. Ebu Talib r.a..

<sup>74</sup> Shënon Mensur Dejlemi në *Musnedul-firdeus*, nga Ebu Seid, me daif-sened. Ebu Ja’la dhe Ukajli transmetojnë pjesën e parë të këtij hadithi, nga Ebu Bekr, në mesin e transmetimeve daif.

Abdulvehhab Verrak tregon:

*“Ahmed b. Hanbeli më pyeti një herë se çfarë zanati kam, e kur i tregova që shkruaj, ai ma ktheu:*

*- Kjo është mënyrë e bukur për të fituar hallall.*

*Po të kisha ndonjë zanat, do ta zgjedhja bash këtë’, dhe shtoi:*

*- Kur shkruan, shkruaj vetëm në mes të fletës, e fillimisht përcakto gjerësinë e margjinave, që ta theksosh tekstin’.”*

Katër zanatçi njihen në popull si njerëz me karakter të lehtë e mendim të dobët: endësi, tregtari i pambukut, prodhuesi i leshit dhe edukatori i fëmijëve.

Kjo me siguri për shkak se këta janë të obliguar të kenë më shumë kontakte me gra e fëmijë, e kontaktet e shpeshta me ata që kanë njohuri më modeste e trashin trurin, njëjtë si kontaktet me të dijshmit që e zhvillojnë.

Muxhahidi tregon për rastin kur hazreti Merjem r.anha ishte duke kërkuar Isanë e vogël,a.s., e kur kaloi pranë një endësi dhe e pyeti për rrugën, ky e udhëzoi në rrugë të gabuar.



Atëherë, Merjemi r.anha bëri dua:

*“Ja Allah, këta mos paqin bereqet në fitim, vdekshin si fukarâ e u poshtërofshin në sytë njerëzve!”* Duaja u pranua...

Myslimanët nga gjenerata e parë refuzonin të merrnin pagë për çkado që konsiderohet ibadet dhe farzi-kifaje, siç është larja e xhenazes, këndimi i ezanit, falja e taravisë, ose mësimi i Kur’anit dhe diturive të sheriatit.

Në fakt, të kërkohet pagesë për to është e lejuar, mirëpo shpërblimi do të duhej të pritet në ahiret, e nëse paguhet në dynja, kjo është ndërrim i shpërblimit të ahiretit me shpërblim të dynjasë, që nuk është e dëshiruar.

3. Myslimani të mos lejojë që pazari i dynjasë ta ngarkojë aq shumë, sa të mos ketë kohë të shkojë në  *pazar të ahiretit*, e pazar i ahiretit është xhamia.

Allahu Teala thotë:

**“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin.”** 24-Nur: 36-37

Myslimani pra duhet që fillimin e ditës së tij t’ia kushtojë ahiretit, deri në kohën kur niset për pazar, duke qëndruar në xhami e duke bërë dhikrin e tij.

Omeri r.a. u thoshte tregtarëve:

*“Fillimin e ditës jepja ahiretit, e pjesën tjetër – dynjallëkut.”*

Njerëzit e mirë nga radhët e gjeneratave të para të myslimanëve ia kushtonin ahiretit edhe fillimin edhe fundin e ditës, e mesin e saj – dynjasë. Bile në mëngjes, vetëm fëmijët dhe *zimmitë*<sup>75</sup> shisnin pilaf me kokë deleje, gjedhi a deveje, deri sa këta ishin në xhami.

Në një transmetim thuhet:

**“Kur melaqet të ngriten në qiell me fletën ku janë të shkruara veprat që i ka bërë robi - nëse në fillim të ditës dhe në fund të saj e ka dhikrin dhe veprat e mira, Allahu Teala do t’ia fshijë të gjitha të këqijat që i ka bërë mes tyre.”<sup>76</sup>**

---

<sup>75</sup> Zimmi: *jo-mysliman, i cili është pranuar me marrëveshje të qëndrojnë në shtetin Islam.*

<sup>76</sup>Ebu Ja’la, nga Enesi r.a.

E në një transmetim tjetër thuhet:

**“Melaqet e natës dhe ato të ditës takohen në kohën e sabahut e të ikindisë. Allahu Teala i pyet:**

**- Në çfarë gjendje i latë robët e Mi?, e Ai më së miri e di gjendjen e tyre,**

**e melaqet përgjigjen:**

**- I lamë në namaz, e edhe i gjetëm në namaz.**

**Atëherë Allahu Teala thotë:**

**- Bëhuni dëshmitarë që i kam falur!<sup>77</sup>**

Pos kësaj, sa herë që myslimani të dëgjojë ezanin për namazin e drekës ose të ikindisë, do të duhej ta ndërpresë punën, dhe të niset për në xhami.

Vlera që fshihet në tekbirin e parë me imamin, në vaktin e parë të namazit, është më e madhe se vlera e krejt dynjasë, me gjithë çka ka, e ky mund ta humbasë.

Disa dijetarë bile mendojnë se, po të mos i bashkohet xhematit, ky është gjynahqar.

Myslimanët nga radhët e gjeneratave të para, sapo e dëgjonin ezanin nguteshin drejt xhamisë, duke ua lëshuar çarshinë fëmijëve dhe zimmive.

---

<sup>77</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

Për kujdes në dyqan gjatë kohës së namazit paguanin me *kiratë*<sup>78</sup>, që për disa ishte burim i të ardhurave për t'i plotësuar nevojat e jetës.

E në interpretimin e ajetit:

**“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun.”** 24-Nur: 37,

thonë se flitet për farkëtarin, rrobaqepësin dhe këpucarin. Ata, edhe po ta kishin çekanin në dorë apo gjilpërën gati, kur të fillonte ezani, nuk do të godisnin me atë çekan e as që do të shponin me atë gjilpërë, por do t'i skajonin, e do të niseshin për namaz.

4. Myslimani të mos kufizohet me kaq, por ta përmend Allahun Teala edhe sa është në dyqan ose çarshi, duke thënë *La ilahe ilallah ose Subhanallah*.

Të përmendet Allahu në pazar, në mesin e gafilëve<sup>79</sup>, është edhe më e vlefshme.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Ai që përmend Allahun kur është në mesin e gafilëve, është sikur ai që lufton në fushëbetejë kur të tjerët ikin, ose sikur i gjalli në mes xhenazeve”,**  
e në version tjetër:

**...sikur pema e gjelbër në mesin e pemëve të thara.”**

---

<sup>78</sup> një e gjashta e dërhemit

<sup>79</sup> pa vëmendje

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

**“Kush thotë në pazar:**

**- *La ilahe ilallahu vahdehu la sherike leh. Leहुल-  
mulku ve leहुल-hamdu, juhji ve jumuतu, ve huve  
hajjun la jemetu, bi jedihil-hajr, ve huve ala kulli  
shej'in kadir,***

**Allahu Teala i shkruan njëmijë sevape.”<sup>80</sup>**

Ibn Omer, Salim b. Abdullah, Muhammed b. Vasi dhe të tjerë shkonin në pazar dhe bënëin këtë dhikër vetëm që të përfitojnë vlerën e tij.

Hasan Basriu thotë:

*“Kush e përmend Allahun në pazar, në Ditën e Gjykimit vjen për llogari para Allahut Teala me dritë si hënë e plotë dhe me një dëshmi si dielli, e ai që thotë Estagfirullah (kërkoj falje nga Allahu) kur është në pazar, Allahu i falë aq gjynahe sa ka njerëz aty.”*

Omeri r.a. duke hyrë në pazar, thoshte:

*“Ja Allah, tek Ti kërkoj strehim nga kufri, fjalët boshe, dhe nga e keqja që është në çarshi. Allah, tek Ti kërkoj strehim nga beja e rreme dhe nga blerja që bën zarar.”*

---

<sup>80</sup> Imam Ahmed bin Hambel

Ebu Xhafer el- Fergani tregon:

*“Ishim në mexhlisin e Xhunejdit. Njëri filloi të flasë për ata që kalojnë kohën në xhami duke imituar sufitetë e që nuk kujdesen për obligimet e veta, dhe filloi t’i shajë ata që nuk kalojnë kohën në xhami, e shetisin nepër çarshi. Në këtë Xhunejdi tha:*

*- Sa shumë ka prej atyre në çarshi që, do të kishin të drejtë të hynë në xhami, t’i kapin për veshi disa që aty e t’i nxjerrin jashtë, dhe të ulen në vendin e tyre! E njoh njeriun që punon në çarshi, dhe falë treqind rekate namaz e thotë treqind herë ‘Subhanallah’.*

*E kuptova që fliste për vete, sepse dijetarët për vete flasin vetëm kur janë të detyruar.”*

Kjo është tregtia e atyre që me të sigurojnë të nevojshmen, jo bollëkun e dynjasë.

Si mund ta injorojë fitimin e ahiretit ai që dynjanë e kërkon vetëm që përmes saj të arrijë lumturinë e ahiretit? Ai sillet me devotshmëri në pazar, si në xhami a në shtëpi, e shpëtimi është në takvallëk.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Frikësohu nga Allahu Teala, kudo të jesh!”<sup>81</sup>.**

---

<sup>81</sup> Tirmidhiu nga Ebu Dherr, dhe e konsideron sahih.

pra, obligimi për takva nuk hiqet nga ai që i kushtohet fesë, sido që t'i ndërrojë situata në jetë.

Ai jeton me takvallëk, sepse aty gjenë tregtinë që i sjell fitim të përjetshëm.

Dikush ka thënë:

*“Kush e do më shumë ahiretin, ai vërtetë jeton, e kush e do më shumë dynjanë, ai është i humbur. Ahmaku kalon ditën bosh, e i mençuri mendon për të metat e veta.”*

5. Mos ta dëshirojë së tepërmi çarshinë dhe tregtinë - në të mos të hyjë i pari e të dalë i fundit, e për të mos t'i kalojë oqeanet!

Këto të dyja nuk janë të lavdërueshme.

Thonë se ai që për tregti kalon detëra, është lëshuar së tepërmi në kërkim të riskut, sepse edhe në hadith thuhet:

**“Në det udhëtohet veç për haxh e umre, a për luftë.”<sup>82</sup>**

Abdullah b. Amr As r.a., ka thënë:

*“Mos u bëj i pari që hyn në pazar, e i fundit që del prej aty! Në të banon shejtani, dhe aty shtrihet.”*

---

<sup>82</sup> Ebu Davud, nga Abdullah b. Amr. Thonë se ka sened të këputur.

Nga Muadh b. Xhebel dhe Abdullah b. Omeri r.a., tregohet kjo:

*“Iblisi i thotë djalit të vet, Zelenburit:*

*- Shko me çetat tua te pazарxhitë, e shfaquni si të bukur gënjeshtërën, betimin, mashtrimin e intrigat dhe qëndro me atë që i pari hyn në të, e i fundit del nga aty’.”*

Me hadith thuhet:

**“Vendet më të sherrit janë pazaret dhe çarshitë, e më i keqi është ai që i pari futet në të, e i fundit del prej aty.”<sup>83</sup>**

Mbrojtja më e mirë për myslimanin është të mos kalojë kufirin e mjaftueshmërisë së fitimit, e kur mbërrinë aty, t’i kthehet ahiretit.

Ashtu kanë vepruar myslimanët e mirë nga gjeneratat e para. E në mesin e tyre ka pasë edhe të tillë që, sapo kanë fituar dërhemin e parë janë larguar nga aty, të kënaqur.

Hammad b. Seleme shiste shamikoke për femra me një shportë që mbante përpara. Sapo i fitonte dy habbe (1/48 pjesë e dërhemit), e merrte shportën dhe shkonte.

---

<sup>83</sup> Shënon Ebu Nuajm, në *“Hurmetu’l-Mesacid’*. Transmetim të ngjashëm ka edhe nga Ibn Abbas r.a..



Ibrahim b. Beshar tregon:

*“I thashë Ibrahim b. Ed’hemit:*

*- A të punoj sot edhe me argjilë?, e ai m’u përgjigj:*

*- O i biri i Besharit, ti po kërkon e ty po të kërkojnë; ty po të kërkon ajo që nuk mund t’i ikësh, e ti po e kërkon atë që e ke me bollëk. A nuk e ke parë të pangopurin e privuar, dhe të dobëtin, e që ka mjaft?*

*I thashë:*

*- Te bakalli kam vetëm një dërrhem, e ai ma ktheu:*

*- E, çfarë dëshiron më?*

Disa prej tyre largoheshin nga pazari pas namazit të drekës, disa pas ikindisë, e kish edhe të atillë që punonin vetëm një ditë a dy në javë, e me kaq mjaftoheshin.

6. Myslimani të mos kufizohet vetëm në largim nga harami, por të ketë kujdes edhe nga gjërat e dyshimta.

Në këtë nuk duhet të kërkojë mendimin e të tjerëve, por të dëgjojë zemrën e vet. Nëse në zemër ndjen parehati për diçka, le ta evitojë!

Nëse i sjellet mall me përmbajtje ose prejardhje të dyshimtë, le të pyes për të, sepse mund të përfundojë duke përdorur diçka të dyshimtë.

I sollën qumësht Resulallahut s.a.v.s., e ai pyeti:

- **Çfarë qumështi është ky?**

- *Qumësht deleje*, i thanë, e ai pyeti:

- **Ku e keni marrë delen?**

- *Nga filan vendi*, iu përgjigjën.

Resulallahu s.a.v.s., e piu qumështin, e më pas tha:

- **Neve peygamberëve na është urdhëruar të ushqehemi vetëm me hallall, e të veprojmë vetëm mirë.**<sup>84</sup>

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

**“Allahu Teala u ka urdhëruar besimtarëve atë që u ka urdhëruar edhe peygamberëve<sup>85</sup>, prandaj thotë:**

***‘O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë...’*** (2-Bekare: 172)

Resulallahu s.a.v.s., pyeste për prejardhjen e diçkaje, pastaj për prejardhjen e prejardhjes (pra për qumështin, pastaj delen) por nuk shkonte tutje, sepse pas kësaj është vështirë të hulumtohet.

---

<sup>84</sup> Taberani, nga Ummu Abdullah r.a.

<sup>85</sup> Muslimi, nga Ebu Hurejre r.a.

Por Resulallahu s.a.v.s., nuk pyeste për gjithçka që i sillnin. Në librin për hallallin e haramin do ta shpjegojmë obligimin për një kontroll të tillë.

Tregtari obligohet të shohë me kë po bën shitblerje. Nuk do të bashkëpunojë me ata që është i njohur për padrejtësi, mashtrim, hajni apo kamatë.

Nuk bashkëpunon asnjëherë me tiranët dhe ushtrinë e tyre, e as me shokët dhe ndihmësit e tyre, sepse kjo është ndihmesë tiranisë.

Një person e kishte marrë për punë ngritjen e një muri të një kështjelle, dhe tregon:

*“Në shpirt m’u lajmërua shqetësim, ani pse kjo llogaritet si punë e hairit, bile edhe si obligim i islamit. Por, emiri i kështjellës ishte zullumqar. E pyeta për këtë Sufjanin r.a., e ai më tha:*

*- Mos iu ndihmo, as pak e as shumë. I thashë:*

*- Por ky është mur për myslimanët, dhe është punë në rrugën e Allahut, e ai më tha:*

*-Po, ama ti më së paku do të bësh dua që emiri të qëndroj aty sa më gjatë, që të paguaj ty, e kështu do t’i dëshirosh jetë të gjatë atij që është kryengritës ndaj Allahut.”*

E në hadith thuhet:

**“Kush e lutë Allahun që zullumqarit t’i zgjatet jeta, ai ka dëshiruar që të shprehet kryengritja ndaj Allahut, në tokën e Tij.”<sup>86</sup>**

Në një tjetër hadith thuhet:

**“Allahu zemërohet kur lavdërohet gjynahqari.”<sup>87</sup>**

E edhe në një tjetër hadith:

**“Kush shpërblenë gjynahqarin ndihmon rrënimin e islamit.”<sup>88</sup>**

Shkoi Sufjan Sevri te Mehdiu, e ky po mbante një copë letre të bardhë në dorë, dhe i tha Sufjanit:

- *Ma jep shishen e bojës, dua të shkruaj diçka.*

Ky i tha:

- *Një herë më trego se çka do të shkruash, nëse është e vërtetë, ta jap.*

Një udhëheqës kërkoi vulën nga një i ditur të cilin e kishte arestuar, për të vulosur një letër. Ky i tha:

- *Një herë ti më jep letrën të shoh çfarë ka në të!*

---

<sup>86</sup> Ibn Ebi'd-Dunja në *‘Kitabu’s-Samt’*, si thënie të Hasanit r.a..

<sup>87</sup> Ibn Ebi'd Dunja në *“Kitabu’s-Samt’*, Ibn Adijj në *‘El-Kamil’*, Ebu Ja’la dhe Bejhekiu në *‘Shuabu’l-Iman’* nga Enesi r.a.

<sup>88</sup> I njohur me verzion tjetër nga Ibn Adijj prej Ajshes r.anha, Taberani në *‘Evsat’* dhe Ebu Nuajm në veprën *‘Hilje’*, nga Abdullah b. Jusri.

Kështu ata kujdeseshin që të mos ndihmojnë zullumqarin. Ndihma më e madhe atyre është nëse bëhet tregti me ta, prandaj besimtarët duhet të ikin nga të gjitha mënyrat e tregtisë me ta.

Shkurtimisht, tregtari duhet të ndajë njerëzit në dy kategori: ata me të cilët do të bashkëpunojë, dhe ata me të cilët nuk do ta bëjë këtë.

Ata me të cilët bashkëpunon, në këtë kohë, le të jenë më të pakët në numër se ata me të cilët nuk bashkëpunon.

Dikush pat thënë:

*“Ishte një kohë kur njeriu shkonte në pazar e pyeste:*

*- Kënd ma preferoni për bashkëpunim?, e i thonin:*

*- Kë të duash!*

*Më pas erdh koha kur i thonin:*

*- Mos bashkëpunoj me askë, përpos me filanin e filanin.*

*Frikësohem se do të vije koha kur nuk do të ketë as kaq.”*

Duket se koha që i është frikësuar ky i urtë tashmë ka ardhur.

*Innâ lillâhî ve innâ ileyhi râciûn* (Të gjithë jemi të Allahut, e të gjithë te Ai kthehemi!).

7. Myslimani të ketë kujdes se si do të bashkëpunojë me secilin partner.

Në këtë rast, ai është që i përcjellë dhe pranon llogaritë, prandaj edhe le të përgaditet që për secilën vepër dhe fjalë të tij të jap llogari.

Thuhet se tregtari, në Ditën e Gjykimit, do të qëndrojë pranë secilit që i ka shitur diçka, dhe do të japë llogari për secilin prej tyre, veç e veç, sado që të jetë i madh numri i tyre.

Dikush ka treguar:

*“Pashë në ëndërr një tregtar, dhe e pyeta:*

*- Çfarë bëri Allahu me ty?’, e ai m’u përgjigj:*

*- Para meje u hapën pesëdhjetë mijë fletë, dhe pyeta: ‘A të gjitha këto janë gjynahe?’. Më thanë: ‘Këto janë bashkëpunimet tua me të tjerët. Është shënuar secili njeri me të cilin ke bashkëpunuar në dynja’. Secili kishte fletën e vet, dhe aty të shënuar çfarë ka ndodhur mes meje e tij, prej fillimit deri në fund të bashkëpunimit tonë.’”*

Ky është obligim i atij që fiton gjatë bashkëpunimit me tjerët, e lidhur me drejtësi, bamirësi dhe kujdes për fenë.

Nëse kufizohet në drejtësi, do të jetë njëri nga të mirët.

Nëse kësaj ia shton edhe bamirësinë, do të jetë një nga ata që janë afër Allahut.

E nëse, bashkë me të gjitha këto, kujdeset edhe për obligimet të fesë, ashtu siç u përshkrua në kapitullin e pestë, do të jetë një nga siddikët, e Allahu e di më së miri se çka është e drejtë.

Hamd Allahut që me mirësinë e Tij, këtu përfundon '*Kitabu Âdâb'il-Kesb ve'l-Meâsh*' (Libri mbi rregullat e sjelljes gjatë fitimit dhe sigurimit të jetesës).





